



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 224

Tiranë – E enjte, 21 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 71, datë 6. 12.2017	Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”..... 11913
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 72, datë 6.12.2017	Për miratimin e rregullores “Për planet e rimëkëmbjes së bankave”..... 11926
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 73, datë 6.12.2017	Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”..... 11957
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 74, datë 6.12.2017	Për disa ndryshime në rregulloren “Për sistemin e kontrollit të brendshëm”..... 11961

**VENDIM****Nr. 71, datë 6. 12.2017****PËR MIRATIMIN E DISA
NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN
“PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT
QENDROR TË REGJISTRIMIT DHE
SHLYERJES SË TITUJVE (AFISaR)”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” dhe të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”, miratuar me vendimin nr. 76, datë 18.12.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, përmbajtja e pikave 26 dhe 47 ndryshon përkatësisht si më poshtë:

“26. “Kontrata tip” është kontrata e pjesëmarrjes në AFISaR, sipas shtojcave 1,1/1, 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, e cila lidhet me administratorit dhe pjesëmarrësit, për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe shlyerjes së transaksioneve me tituj. Në të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, të cilat rrjedhin nga pozicionet e tyre në sistem në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje”;

“47. “Profil i pjesëmarrësit” është bashkësia e të dhënave të pjesëmarrësit, të cilat regjistrohen në sistem dhe e identifikojnë atë në mënyrë unike, sipas shtojcave 10, 10/1 dhe 11 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje”;

b) Në nenin 4, pas pikës 80 shtohen pikat 81 dhe 82 me përmbajtje përkatësisht si vijon:

“81. “Bursa e Titujve” është një treg i rregulluar për të kryer veprime me tituj në përputhje me licencën që është pajisur”;

“82. Sistemi i Bursës së Titujve” është platforma që përdor Bursa e Titujve për të mbështetur realizimin e veprimeve me tituj ndërmjet anëtarëve të saj”.

c) Në nenin 15, pika 1, shkronja “a”, shfuqizohet nënparagrafi “vii”;

d) Në nenin 15, pika 1, pas shkronjës “b”, shtohet paragrafi me shkronjën “c” me përmbajtje si më poshtë:

“Bursa e Titujve, e cila dërgon instruksione shlyerjeje për llogari të klientëve të saj në sistem nëpërmjet VPN-së. Këtë kapacitet e kanë të gjithë pjesëmarrësit e licencuar nga autoritetet përkatëse”;

e) Në nenin 21, shkronja “d” ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“Administratori në bashkëpunim me kandidatin, përcaktojnë dhe zbatojnë kalendarin e anëtarësimit si në shtojcën 12”.

f) Në nenin 25, pika 2, shkronja “a” ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“të aksesojnë sistemin AFISaR në çdo kohë gjatë ditës së operimit, duke respektuar oraret e tij të punës sipas shtojcës 7”.

g) Pas kreut IV, shtohet kreu IV/1 me përmbajtje si më poshtë:

**KREU IV/1
BURSA E TITUJVE****Neni 26/1****Bursa e Titujve dhe kushtet për pjesëmarrje**

1. Bursa e Titujve ka akses në sistemin AFISaR nëpërmjet VPN-së. Dërgimi i instruksioneve të shlyerjes realizohet nëpërmjet ndërfaqes AFISaR/Bursë Titujsh. Bursa e Titujve nuk ka llogari vetjake në AFISaR. Bursa ka kapacitetin për të dërguar instruksione vetëm për llogari të anëtarëve të saj.

2. Bursa e Titujve për të pasur akses në AFISaR duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë nënshkruar kontratën tip të pjesëmarrjes në sistemin AFISaR me administratorin sipas shtojcës 1/1;

b) të ketë nënshkruar kontratë me anëtarët e saj, me anë të së cilës anëtarët autorizojnë Bursën për të dërguar instruksione shlyerjeje në AFISaR për llogari të tyre ose klientëve të tyre;

c) të marrë pjesë në sistemin AFISaR vetëm nëpërmjet drejtorisë së saj;

d) të plotësojë të paktën një nga mënyrat e lidhjes të përcaktuara në nenet 44 dhe 45;

e) të ketë hartuar rregulla të brendshme operimi për sistemin AFISaR, sipas udhëzimeve të administratorit;

f) të ketë personel të kualifikuar dhe të trajnuar për operimin në sistemin AFISaR;



g) të ketë marrë nga administratori certifikatën e pjesëmarrjes në sistemin AFISaR.

Neni 26/2

Procedura për anëtarësimin e Bursës së Titujve

1. Procedura për anëtarësimin e Bursës së Titujve me të drejtë aksesimi në sistemin AFISaR nëpërmjet VPN dhe ndërfaqes AFISaR/Bursë Titujsh, kalon nëpër këta hapa:

a) Bursa e titujve i paraqet administratorit një kërkesë me shkrim për anëtarësimin e tij në sistemin AFISaR, bashkë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton licencimin.

b) Administratori shqyrton kërkesën e kandidatit për anëtarësim dhe i kthen përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e marrjes së kërkesës;

c) në rast të miratimit të kërkesës, administratori informon Bursën e Titujve për plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 26/1, duke i vënë në dispozicion të gjithë bazën rregullative;

d) administratori në bashkëpunim me kandidatin, përcaktojnë dhe zbatojnë kalendarin e anëtarësimit si në shtojcën 12;

e) administratori trajnon përdoruesit e ardhshëm të kandidatit dhe drejton testimin për certifikimin e kandidatit;

f) pas përfundimit me sukses të provave dhe pasi sigurohet për përputhshmërinë e rregullave të brendshme të kandidatit me këtë rregullore, lëshon një certifikatë për kandidatin si pjesëmarrës në sistemin AFISaR;

g) kandidati për pjesëmarrës plotëson formularët në shtojcën 19;

h) kandidati për pjesëmarrës nënshkruan kontratën tip të pjesëmarrjes në sistemin AFISaR, me administratorin e sistemit, sipas shtojcës 1/1;

i) administratori kryen veprimet e tij për VPN, *Firewall* përgatitjen e certifikatave të sigurisë;

j) administratori njofton pjesëmarrësin për datën që do t'i jepet akses në sistemin AFISaR të paktën 5 (pesë) ditë punë përpara kësaj date.

Neni 26/3

Detyrimet e Bursës së Titujve në sistemin AFISaR

1. Bursa e Titujve në sistemin AFISaR është e detyruar të:

a) zbatojë rregullat dhe procedurat e sistemit AFISaR;

b) kanalizojë instruksionet në sistemin AFISaR nëpërmjet ndërfaqes, vetëm nga personat e autorizuar;

c) administrojë sistemet e tij lokale, për të siguruar vazhdimësinë dhe dërgimin e instruksioneve të pagesave në sistemin AFISaR;

d) sigurojë personel të kualifikuar, të autorizuar për operim në ndërfaqen AFISaR/Bursë Titujsh;

e) mos lejojë personelin e përkohshëm apo të jashtëm të operojë në ndërfaqen AFISaR/Bursë Titujsh;

f) njoftojë administratorin në rast të lëvizjes së personelit që ka operuar në ndërfaqen AFISaR/Bursë Titujsh, për anulimin e certifikatës së këtij përdoruesi;

g) hartojë procedura të brendshme për sigurinë dhe për mbrojtjen e sistemit, duke përfshirë procedurat organizative (burimet njerëzore dhe pajisjet) dhe ato informatike (elementet *hardware* dhe *software*), në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;

h) sigurojë integritetin e transaksioneve dhe akseseve të përdoruesve brenda institucionit duke:

i) lokalizuar çdo pikë lidhjeje primare apo *backup* në ndërfaqen AFISaR/Bursë Titujsh, vetëm aty ku ka akses të përshtatshëm për mjetet dixhitale të telekomunikimit, për konfigurimet e duhura të autenticitetit dhe të mjeteve të sigurisë, si dhe të ekzistojë siguria që funksionimi i ndërfaqes AFISaR/Bursë Titujsh nuk do të jetë subjekt i ndërprerjeve apo i ndërhyrjeve të shkaktuara nga faktorët e brendshëm apo të jashtëm;

ii) zbatuar parimin “katër sytë” për autorizimin e urdhërpagesës, duke siguruar përdorues të ndryshëm për hedhje të dhënash dhe aprovim të tyre;

iii) kryer ekzekutimin e instruksioneve të pagesës, sipas procedurave që respektojnë të drejtat minimale në përputhje me rolin dhe përgjegjësitë e kategorive të ndryshme të personelit

iv) kryer vlerësime periodike mujore mbi ngjarjet e paparashikuara në ndërfaqen AFISaR/



Bursë Titujsh, sipas shtojcës 16 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje dhe t'i dërgojnë zyrtarisht pranë administratorit, çdo muaj;

v) raportuar çdo muaj janar pranë administratorit për çdo shkelje të vërejtur apo të dyshuar të sigurisë, si dhe të integritetit dhe të qëndrueshmërisë së pajisjeve të tyre të brendshme që lidhen me sistemin AFISaR, sipas shtojcës 15 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 26/4

Kufizimi i përkohshëm dhe përjashtimi i Bursës së Titujve në sistemin AFISaR

1. Administratori ka të drejtë të kufizojë përkohësisht ose të përjashtojë Bursën e Titujve në sistemin AFISaR.

2. Administratori vendos kufizime mbi pjesëmarrësin në rastet e mëposhtme:

a) me njoftim zyrtar të autoritetit përkatës për kufizimin e përkohshëm të licencës për të kryer veprime me titujt për llogari të anëtarëve të tij;

b) me kërkesë zyrtare nga autoriteti përkatës licencues ose nga prokuroria/gjykata për kufizimin e përkohshëm të aktivitetit të pjesëmarrësit;

c) pjesëmarrësi dështon në plotësimin e qoftë dhe njërit prej kushteve të përcaktuara në nenet 26/1 dhe 26/3;

d) kanë filluar procedurat e likuidimit;

e) pjesëmarrësi dështon në zbatimin e kësaj rregulloreje në mënyrë të pajustifikuar dhe/ose për më shumë se 3 (tre) ditë pune;

f) vendosjen e ndonjë embargoje kundrejt shtetit në të cilin ka rezidencën pjesëmarrësi;

g) me kërkesë me shkrim të vetë pjesëmarrësit dhe me miratimin e saj nga administratori.

3. Pjesëmarrësi i kufizuar përkohësisht ka detyrimin të vazhdojë të përmbushë detyrimet e veta financiare dhe jo vetëm, në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore.

4. Kufizimi i pjesëmarrjes së përkohshme bëhet nëpërmjet kufizimit të ndërfaqes së pjesëmarrësit. Pjesëmarrësi mund të kryejë veprime me këtë ndërfaqe vetëm me aprovim të arsyetuar të autoritetit përkatës.

5. Administratori vendos shfuqizimin/revokimin e kufizimit të përkohshëm kur pjesëmarrësi ka përmbushur detyrimet e kërkuara për të përfunduar kufizimin dhe/ose autoritetet përkatëse të cilat kanë marrë vendimin për

kufizimin e përkohshëm, njoftojnë për përfundimin e nevojës për kufizim.

6. Administratori njofton menjëherë për vendimin për kufizim të përkohshëm të aksesit të pjesëmarrësit ose shfuqizimin/revokimin e këtij vendimi vetë pjesëmarrësin dhe pjesëmarrësit e tjerë.

7. Administratori vendos për përjashtimin e Bursës së Titujve nga sistemi AFISaR, kur plotësohet të paktën njëra nga rrethanat e mëposhtme:

a) me kërkesë me shkrim të vetë pjesëmarrësit, menjëherë pas miratimit nga administratori të kërkesës;

b) pjesëmarrësi bashkohet/përthithet me/nga një/disa pjesëmarrës të tjerë;

c) administratorit i komunikohet vendimi për likuidimin/paaftësinë paguese apo në rastet kur vendimi për heqjen e licencës nga autoriteti përkatës është përfundimtar dhe i parevokueshëm;

d) pjesëmarrësi shkel në mënyrë të përsëritur dispozitat e kësaj rregulloreje. Në këtë rast, administratori duhet të sigurohet që pjesëmarrësit i është dhënë mundësia të shprehë mendimin e tij.

8. Përpara kryerjes së procedurës së përjashtimit të pjesëmarrësit, administratori sigurohet që nuk ka pagesa në hyrje nga ndërfaqja.

9. Në rast se përjashtimi i pjesëmarrësit është i pamundur për shkak të instruksioneve në hyrje nga ndërfaqja, pjesëmarrësi kufizohet përkohësisht, deri sa të kryhen procedurat për transferimin e këtyre instruksioneve.

10. Administratori njofton menjëherë për vendimin për përjashtimin e pjesëmarrësit, vetë pjesëmarrësin dhe pjesëmarrësit e tjerë.

11. Administratori ndalon operimin e ndërfaqes së pjesëmarrësit të përjashtuar. Të dhënat historike për këtë pjesëmarrës mbeten në databazë.

12. Pjesëmarrësi është i detyruar të paguajë të gjitha detyrimet ndaj administratorit për pjesëmarrjen në sistem, që kanë lindur përpara vendimit për përjashtimin e tij.

13. Administratori kryen procedurat e përcaktuara për ndërprerjen e lidhjes me pjesëmarrësin duke çaktivizuar certifikatën.

h) Neni 44 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

"1. Aksesit për komunikimin nëpërmjet VPN-së do t'u jepet vetëm pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë dhe Bursës së Titujve, që kanë të drejtë për këtë



mënyrë komunikimi, sipas përcaktimeve në rregulloren për “Sigurinë e Informacionit” të Bankës së Shqipërisë.

2. Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë që komunikojnë nëpërmjet VPN-së, do të kenë mundësi të aksesojnë sistemin nëpërmjet *webstation*-it. Ky akses u jep mundësi:

a) të iniciojnë udhëzimet për të debituar/kredituar llogarinë e tyre ose të klientëve të tyre. Udhëzimet kryhen nga *workstation*-i, duke dërguar mesazhe të përcaktuara sipas tipit të transaksionit në shtojcën 6;

b) të monitorojnë statusin e transaksionit të tyre, duke lexuar statutet e përshkruara në shtojcën 6;

c) të monitorojnë llogarinë e tyre dhe të klientëve të tyre;

d) të monitorojnë ngjarjet që lidhen me titujt, siç janë pagesat e kuponëve dhe maturimet;

e) të realizojnë pjesëmarrjen në ankand primar për llogari të tyre dhe të klientëve të tyre;

f) të marrin të gjithë informacionin që lidhet me rezultatin e pjesëmarrjes në ankandin primar;

g) të monitorojnë përdorimin e sistemit nga përdoruesit e tyre.

3. Bursa e Titujve që komunikon nëpërmjet VPN-së, do ketë mundësi të aksesojë sistemin nëpërmjet ndërfaqes elektronike. Ky akses i jep mundësi:

a) të iniciojë udhëzimet për të debituar/kredituar llogaritë e anëtarëve të saj;

b) të marrë informacione mbi statusin e transaksioneve.”

i) Në nenin 50, pika 4, shkronja “b” ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“Komision mirëmbajtjeje”

j) Në nenin 55, pika 1 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“Orari i punës së sistemit AFISaR është i përcaktuar në shtojcën 7, por administratori ka të drejtë t’i modifikojë edhe gjatë ditës së punës, për të ruajtur mbarëvajtjen e sistemit”.

k) Pas shtojcës 1, shtohet shtojca 1/1 me titull “Kontrata tip për pjesëmarrjen e Bursës së Titujve”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

l) Përmbajtja e shtojcës 4 me titull “Kontrata për shlyerjen e transaksioneve në *cash* që gjenerohen nga veprimet me tituj të personave fizikë që e kanë llogarinë e titullit në Bankën e Shqipërisë” ndryshon sipas shtojcës 4 bashkëlidhur

dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

m) Përmbajtja e shtojcës 8 me titull “Komisionet e aplikuara në sistemin AFISaR” ndryshon sipas shtojcës 8 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

n) Pas shtojcës 10, shtohet shtojca 10/1 me titull “Informacion mbi Bursën e Titujve” bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

o) Përmbajtja e shtojcës 12 ndryshon sipas përmbajtjes së shtojcës 12 me titull “Anëtarësimi në AFISaR i një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë dhe Bursës së Titujve” bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Të autorizojë Drejtorin e Departamentit të Operacioneve Monetare të nënshkruajë kontratën tip për pjesëmarrjen e Bursës së Titujve në sistemin AFISaR, sipas përmbajtjes së shtojcës 1/1 dhe kontratën tip për shlyerjen e transaksioneve në *cash* që gjenerohen nga veprimet me tituj të personave fizikë që e kanë llogarinë e titullit në Bankën e Shqipërisë, sipas përmbajtjes së shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë, si dhe pjesëmarrësit e sistemit AFISaR.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Gent Sejko

SHTOJCA 1/1
KONTRATA TIP PËR PJESËMARRJEN E
BURSËS SË TITUJVE

Kontrata e pjesëmarrjes së Bursës së Titujve në Sistemin AFISaR (*Albanian Financial Instruments Settlement and Registrations*)

Palët:

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Administratorit të Sistemit AFISaR (më poshtë referuar si “Administratori”), me adresë: Sheshi “Skënderbej”,



nr. 1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë kontratë nga zoti Marian Gjermani, Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare,
dhe

_____, në cilësinë e Bursës së Titujve (më poshtë referuar si “Bursa e Titujve”), me adresë zyre në _____, me Licencë _____, përfaqësuar në këtë kontratë nga zonja/zoti me numër pasaporte/kartë identiteti _____.

Duke qenë se:

1. Në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, Banka e Shqipërisë është agjent fiskal i Qeverisë;

2. Në bazë të nenit 31 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë së Republikës së Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë, në cilësinë e agjentit fiskal të Qeverisë, krijon, mban sistemin e regjistrimit në llogari për titujt e shtetit, si edhe mbështet krijimin e tregut sekondar të titujve të shtetit, duke lehtësuar përdorimin e sistemit të regjistrimit; dhe

3. Në bazë të nenit 12, të vendimit nr. _____, datë _____2014, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, “Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe të shlyerjes së titujve (AFISaR)”” (më poshtë referuar si “Rregullorja”), subjekti që dëshiron të marrë pjesë në sistemin AFISaR, duhet të lidhë me administratorin kontratën e pjesëmarrjes në sistemin AFISaR,

bien dakord të lidhin këtë kontratë sipas kushteve të mëposhtme.

Neni 1

Objekti

Objekti i kontratës është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të administratorit, të cilat lindin në kuadrin e ofrimit prej tij të shërbimeve të shlyerjes dhe regjistrimit të titujve në sistemin AFISaR, si pronar dhe administrator i vetëm i këtij sistemi, si dhe të pjesëmarrësit në këtë sistem, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate dhe Rregullores.

Neni 2

Baza ligjore

Kontrata hartohet në bazë të neneve 659 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores së Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime dhe interpretime

1. Termat e përdorur në kontratë kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në Rregullore.

2. “Dokumentacioni” është tërësia e rregullave që rregullojnë sistemin AFISaR, ku përfshihen: Rregullorja e Sistemit AFISaR, Manuali i përdorimit të sistemit AFISaR, Manuali SWIFT i sistemit AFISaR.

3. Çdo kusht ose dispozitë e kontratës, që mund të sjellë paqartësi interpretohet në kontekstin e Rregullores dhe në këndvështrimin e qëllimit për të cilin palët lidhin këtë kontratë.

4. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë kontratë, zbatohen dispozitat e Rregullores dhe, në rast se këto të fundit nuk rregullojnë çështje të veçanta, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të fushës të cituara edhe në bazën ligjore të Rregullores.

Neni 4

Kërkesa për aplikim

Kërkesa për aplikim, së bashku me dokumentet e kërkuara sipas Rregullores, të dorëzuara nga Bursa e Titujve, i bashkëlidhen kontratës dhe janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 5

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj për një kohë të pacaktuar.

Neni 6

Mjeti dhe format e komunikimit

1. Për dërgimin/marrjen e instruksioneve të pagesës në lidhje me transaksionet me titujt që regjistrohen dhe shlyhen në sistemin AFISaR, Bursa e Titujve përdor si mënyrë komunikimi:

VPN ☐

SWIFT ☐



2. Administratori, pasi aprovon mënyrën e komunikimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, detajon specifikimet teknike të komunikimit në përputhje me Rregulloren.

Neni 7

Llogaritë

Bursa e Titujve është pjesëmarrës që operon pa llogari titujsh në sistemin AFISaR. Ajo dërgon instruksione shlyerëse për llogari të anëtarëve të saj në AFISaR, nëpërmjet ndërfaqes.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

1. Banka nuk mban përgjegjësi për saktësinë e instruksioneve të shlyerjes që Bursa e Titujve dërgon në mënyrë elektronike në sistemin AFISaR.

2. Banka nuk mban përgjegjësi në rast mosekzekutimi të pagesave për pamjaftueshmëri të fondeve të anëtarëve të Bursës së Titujve në sistemin AIPS.

3. Bursa e Titujve është përgjegjëse për sigurinë e transmetimit elektronik deri në Bankë.

4. Në rast të problemeve në rrjetin VPN, të pavarura nga Banka, kjo e fundit nuk ndërmerr plan *backup* për zgjidhjen e situatës. Bursa e Titujve merr masa për funksionimin e rrjetit VPN pranë saj.

5. Banka, në asnjë rast nuk ndërhyr në instruksionet e shlyerjes që dërgon Bursa e Titujve në AFISaR.

6. Bursa e Titujve është përgjegjëse për administrimin e kredencialeve në VPN.

7. Banka dhe Bursa e Titujve periodikisht kryejnë procedurat teknike për gjenerimin e certifikatës për nënshkrimin digjital të *file*-ve.

8. Administratori dhe Bursa e Titujve kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcaktohen në Rregulloren, e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar.

9. Në rast të hasjes së problemeve në ndërfaqen elektronike të cilat nuk zgjidhen me procedurat e përcaktuara në rregulloren/kontratë, palët dakordojnë zgjidhjet rast pas rasti.

Neni 9

Komisionet e pjesëmarrjes

1. Bursa e Titujve paguan komisionet e parashikuara në nenin 50, pika 4, shkronjat “b” dhe “c” të Rregullores.

2. Komisionet për instruksionet shlyerëse paguhen nga anëtarët e saj, palë në transaksion.

Neni 10

Komunikimi nëpërmjet ndërfaqes

1. Bursa e Titujve dërgon instruksione shlyerëse nëpërmjet ndërfaqes AFISaR/Bursë Titujsh. Nëpërmjet ndërfaqes Bursa e Titujve ngarkon *file*, të cilat përmbajnë informacionin e nevojshëm për instruksionet shlyerëse të tipit MT543. Sistemi AFISaR do të gjenerojë *file* me instruksione të tipit MT 545, MT547 dhe MT548, të cilat njoftojnë Bursën e Titujve për statusin e transaksionit të iniciuar prej tyre.

2. Mënyra e funksionimit të ndërfaqes është detajuar me dakordësinë e palëve dhe është pjesë përbërëse e një dokumenti të veçantë.

Neni 11

Konfidencialiteti

Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të dhënë në mënyrë reciproke, duke bërë përpjekjet maksimale për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur numrin e personave që disponojnë këtë informacion.

Neni 12

Masa administrative

Administratori ka të drejtë të marrë masat e parashikuara në Rregulloren, në rast se Bursa e Titujve nuk e ushtron veprimtarinë në përputhje me Rregulloren, me dokumentacionin, si edhe me instruksionet e dhëna prej tij.

Neni 13

Ndryshimet e kontratës

Kushtet e kontratës ndryshohen me nënshkrimin e të dyja palëve.

Neni 14

Forca madhore

Palët nuk janë përgjegjëse për mospërbushjen e detyrimeve kontraktore për shkak të forcës madhore, për të cilën njoftojnë menjëherë njëra-tjetrën.



Neni 15 Njoftimet

1. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër formal ndërmjet palëve, me përjashtim të komunikimit të përcaktuar në nenin 6 të kësaj kontrate, kryhet me postë zyrtare të regjistruar, faks, *e-mail* ose në rast pamundësie, kryhet me telefon.

2. Në rast se njoftimi, kërkesa ose komunikimi mbërrin tek i adresuari pas orës 16:30, ai konsiderohet i marrë në orën 08:30 të ditës pasardhëse të punës.

3. Palët njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e mundshme të adresave, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga ndryshimi i tyre.

4. Palët njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për ndryshimet e mundshme të përfaqësuesve të tyre.

Neni 16 Zgjidhja e kontratës

1. Palët mund të zgjidhin kontratën me mirëkuptim ose në mënyrë të njëanshme për mospërbushje të detyrimeve të rëndësishme, duke njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës që ato dëshirojnë të zgjidhin kontratën, duke kërkuar plotësimin e detyrimeve financiare të maturuara, të cilat mund të rrjedhin nga kjo kontratë.

2. Për të gjitha rastet e tjera të zgjidhjes së kësaj kontrate që nuk parashikohen në të, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve në zbatim të kësaj kontrate dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, zgjidhen pranë Gjykatës kompetente.

Neni 18 E fundit

1. Për pjesëmarrësit rezidentë, kontrata nënshkruhet në 2 (dy) njësi origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban një njësi.

2. Për pjesëmarrësit jorezidentë, kontrata nënshkruhet në 4 (katër) njësi origjinale: 2 (dy) në gjuhën shqipe dhe 2 (dy) në gjuhën angleze dhe secila nga palët mban nga 1 (një) në gjuhën shqipe dhe 1 (një) në gjuhën angleze.

3. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet kontratës në gjuhën shqipe dhe asaj në gjuhën angleze, mbizotëron dhe është e detyrueshme kontrata në gjuhën shqipe.

4. Kontrata, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur.

Për Bankën e Shqipërisë:

Për _____

Marian Gjermani

Drejtor i Operacioneve Monetare _____

SHTOJCA 4 KONTRATA PËR SHLYERJEN E TRANSAKSIONEVE NË CASH QË GJENEROHEN NGA VEPRIMET ME TITUL TË PERSONAVE FIZIKË QË E KANË LLOGARINË E TITULLIT NË BANKËN E SHQIPËRISË

Palët:

Banka e Shqipërisë (më poshtë referuar si “BSH”) me adresë: Sheshi “Skënderbej”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë kontratë nga zoti Marian Gjermani, Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare,

dhe

_____, (më poshtë referuar si “Banka”) me adresë zyre në _____, me licencë _____, përfaqësuar në këtë kontratë nga zonja/zoti _____ me numër pasaporte/kartë identiteti,

bien dakord të lidhin këtë kontratë sipas kushteve të mëposhtme.

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj kontrate është rregullimi i marrëdhënieve midis palëve duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e tyre në procesin e shlyerjes së *cash*-it nga veprimet e kryera në treg primar nga personat fizikë, të cilët kanë llogarinë e titullit në Sportelin e BSH-së.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo kontratë hartohet në bazë të neneve 659 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të Rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe të shlyerjes së titujve (AFISaR).



Neni 3 Përkufizime

1. Në zbatim të kësaj kontrate, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Klient” është personi fizik që merr pjesë në ankandin e tregut primar të emetimit të bonove të thesarit të shtetit shqiptar nëpërmjet Sportelit të BSH-së;

b) “Bono thesari” janë tituj afatshkurtër, emetimi i të cilave rregullohet me udhëzimin për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë e bonove të thesarit në formë regjistrimi dhe në Marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave për “Organizimin e ankandeve të titujve të shtetit shqiptar, shlyerjen e veprimeve dhe mbajtjen e regjistrit të këtyre titujve”;

c) “FTP (*File transfer protocol*)” është një protokoll rrjeti standard që përdoret për të transferuar skedarë nga një kompjuter në një tjetër, mbi një rrjet me bazë TCP, të tillë si Interneti;

d) “Rakordimi” është krahasimi i të dhënave të dërguara nga bankat, të prodhuara në mënyrë automatike nga sistemet e tyre, me të dhënat e prodhuara nga sistemi AFISaR i BSH-së;

e) “Procesi”, në kontekstin e përdorur në këtë kontratë, përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

i) bllokimi i shumës nga personi fizik në bankë,

ii) regjistrimi në sistemin AFISaR i kërkesës së klientit për pjesëmarrjen në ankand nga BSH-ja,

iii) shlyerja e veprimeve në *cash*, që gjenerohet nga pjesëmarrja e klientit në ankandin e tregut primar (emetim/maturim i titullit);

f) “Titull” në kontestin e përdorur në këtë kontratë i referohet vetëm bonove të thesarit;

g) “Vlera neto e *cash*-it” është rezultati i veprimeve për emetimin dhe maturimin e titujve që ndodhin në të njëjtën ditë shlyerjeje;

h) “Person fizik” është individ i me zotësi të plotë juridike;

i) “Organe kompetente” përfshijnë, gjykatën, prokurorinë, organet e tatimeve dhe të tjera që kanë të drejtë me ligj për të vendosur bllokim të llogarive.

2. Për termat e tjerë, palët u referohen termave dhe qëllimit të Rregullores së Sistemit AFISaR, si dhe legjislacionit përkatës të fushës.

“

Neni 4 Regjistrimi i kërkesës

1. Personi fizik paraqitet në një nga degët e bankës dhe kërkon bllokimin e shumës për ankandin për emetimin e bonos së thesarit që dëshiron, duke kryer të gjitha procedurat e nevojshme sipas specifikimeve të bankës.

2. Banka, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit” i ndryshuar, si dhe parashikimeve në nenin 10 të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 44, datë 10.6.2009, i ndryshuar, kryen verifikimin e burimit të fondeve të bllokuara.

3. Personi fizik paraqitet në një nga Sportelet e BSH-së dhe shpreh vullnetin për të marrë pjesë në ankandin për emetimin e bonos së thesarit që dëshiron. Në të njëjtën kohë, paraqet edhe numrin e llogarisë së *cash*-it në bankën tregtare nëpërmjet të cilës do shlyhen veprimet për blerjen e bonos së thesarit.

4. Të dhënat me të cilat personi fizik regjistrohet në bankë dhe në BSH paraqiten sipas aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Neni 5 Rakordimi i të dhënave

1. Rakordimi i të dhënave bëhet nga BSH-ja.

2. Banka dërgon skedarin e të dhënave të përpiluar sipas formatit që përshkruhet në aneksin 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

3. Dërgimi i skedarit bëhet nga banka 1 (një) ditë pune përpara ditës së zhvillimit të ankandit në orën 09:30. Pas kësaj ore banka nuk mund të shtojë apo ndryshojë të dhënat, përveç rasteve të korrigjimit të gabimeve që dalin nga rakordimi.

4. Në rast se ka diferenca nga procesi i rakordimit, BSH-ja komunikon me bankën për sqarimin e diferencave deri në orën 12.00 të ditës së punës përpara ditës së zhvillimit të ankandit. Në orën 16.00 kryhet rakordimi final. Në rast se nuk ka diferenca, BSH-ja konfirmon rakordimin e të dhënave.

5. Në rast se rakordimi final sipas pikës 4 nuk rezulton i plotë, BSH-ja nuk i paraqet në ankand kërkesat e personave fizikë, për të cilët nuk arrihet



rakordimi. BSH-ja njofton bankën dhe klientët për mospranimin e kërkesave të tyre.

Neni 6 Shlyerja

1. Në ditën e shlyerjes së ankandit, BSH-ja debiton/krediton automatikisht llogarinë e bankës në sistemin AIPS për vlerën neto të *cash-it* për veprimet me tituj të secilit prej klientëve të saj.

2. Banka proceson automatikisht këto veprime, duke prekur llogaritë respektive të klientëve, jo më vonë se dita e shlyerjes së ankandit.

3. BSH-ja ka të drejtë të kryejë auditime të procesit të shlyerjes automatike në bankë sipas pikës 2, sa herë që e gjykon të arsyeshme.

Neni 7 Gabimet

1. Në rast se gjatë procesit të shlyerjes automatike pranë bankës, konstatohen gabime të transaksioneve të emetimit të titujve, të cilat nuk mund të ndreqen dhe, në këto kushte, mund të rezultojnë në përfitim të padrejtë të titullit nga personi fizik ndaj të cilit është bërë gabimi, atëherë veprohet si më poshtë:

a) Banka e merr titullin në pronësi të saj. Për këtë kryhen instruksionet e pagesave përkatës në sistemin AFISaR për transferimin FoP në përputhje me rregulloren e sistemit AFISaR;

b) Në rast të pamundësisë së argumentuar për marrjen në pronësi të titullit, atëherë ky i fundit kalon në llogarinë vetjake të titullit të Ministrisë së Financave, pasi është rënë dakord me këtë të fundit për kthimin e çmimit të titullit në llogarinë e bankës. Veprimet kryhen në sistemin AFISaR në përputhje me rregulloren e sistemit.

2. Në rast se gjatë procesit të shlyerjes automatike, pranë bankës të transaksioneve të maturimit të titujve konstatohen gabime, të cilat nuk mund të ndreqen brenda periudhës së përcaktuar për investigim në rregulloren e sistemit AIPS të BSH-së, banka ia kthen BSH-së këtë pagesë sipas instruksioneve të dhëna nga kjo e fundit.

Neni 8 Urdhërblokimet

Në rast se organet kompetente dërgojnë urdhër për bllokimin e llogarive të personit fizik

gjatë kohës që ka nisur procesi, atëherë bllokimi bëhet si më poshtë:

a) në rast se urdhri mbërrin në institucionin përkatës përpara rakordimit final sipas nenit 5, pika 4, bllokimin e bën banka duke njoftuar menjëherë BSH-në për bllokimin e këtij klienti. BSH-ja çregjistron kërkesën e personit fizik dhe bëhet rakordimi final.

b) në rast se urdhri mbërrin në institucionin përkatës pas rakordimit final, bllokimin e bën BSH-ja duke bllokuar llogarinë e titullit të klientit. BSH-ja njofton menjëherë bankën pas marrjes së urdhrit.

Neni 9 Tatimi

Tatimi në burim për interesin në ditën e maturimit të titullit, nëse ka të tillë, mbahet nga BSH-ja.

Neni 10 Mjeti dhe format e komunikimit

1. Mënyra e komunikimit për shkëmbimin e skedarit është nëpërmjet transferimit të *fileve* FTP. Shërbimi FTP aksesohet dhe operon vetëm në rrjetin e sigurt VPN.

2. Mënyra e dërgimit të njoftimit për shlyerjen e veprimeve është nëpërmjet MT900 dhe MT910.

3. Komunikimi për sqarimin e diferencave që dalin gjatë rakordimit ose njoftimet për bllokimet sipas nenit 8, bëhen me telefon dhe/ose *e-mail* zyrtar. Për bllokimet sipas nenit 8, dërgohet edhe shkresë zyrtare.

Neni 11 Njoftimet

Në rast se palët kanë ndryshime në mënyrën dhe teknologjinë e sistemeve me të cilat realizohet procesi, ato njoftojnë njëra-tjetrën të paktën 3(tre) muaj përpara ndryshimeve.

Neni 12 Detyrimet ndaj klientit

1. BSH-ja përgjigjet ndaj personit fizik, klient i saj, për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ka ndaj tij, të shprehura në kontratën e lidhur me të për llogarinë e titullit.

2. Banka përgjigjet ndaj personit fizik për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ka ndaj tij të shprehura në kontratën e lidhur me të për llogarinë e *cash-it*.



Neni 13

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj për një kohë të pacaktuar.

Neni 14

Zgjidhja e kontratës

1. Palët mund të zgjidhin kontratën me mirëkuptim ose në mënyrë të njëanshme për mospërbushje të detyrimeve të rëndësishme, duke njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës që ato dëshirojnë të zgjidhin kontratën.

2. Për të gjitha rastet e tjera të zgjidhjes së kësaj kontrate që nuk parashikohen në këtë kontratë, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve në zbatim të kësaj kontrate që nuk zgjidhen me mirëkuptim, zgjidhen pranë Gjykatës kompetente.

Neni 16

Të fundit

1. Kontrata përpilohet në 4 (katër) njësi në gjuhën shqipe, nga të cilat 2 (dy) njësi i mban BSH-ja dhe 2 (dy) njësi i mban banka.

2. Kontrata, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur.

3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palët, shfuqizohet kontrata e lidhur ndërmjet tyre në datën _____.

Për Bankën e Shqipërisë:

Për Bankën:

Marian Gjermani _____

Drejtor i Operacioneve Monetare _____



SHTOJCA 8
KOMISIONET E APLIKUARA NË SISTEMIN AFISaR

Lloji i komisioneve	Në vlerë (lekë)	Në përqindje
A. Komision për anëtarësim dhe mirëmbajtje		
Komision hyrjeje (anëtarësimi) për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë	250,000	
Komision hyrjeje (anëtarësimi) për pjesëmarrësit e tërthortë	0 (zero)	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e tërthortë (persona juridikë) me llogari titulli në Bankën e Shqipërisë	250,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë	250,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për Bursën e Titujve	100,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e tërthortë me llogari titulli në pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë përveç Bankës së Shqipërisë*	150,000	
Komision daljeje	0 (zero)	
B. Komision për operacionet e veçanta		
Komision (1) procesimi për operacionet DVP (shitje/blerjet, kredi brenda ditës me Bankën e Shqipërisë dhe transaksioni i kthimit, marrëveshje riblerjeje/ të anasjella riblerjeje me Bankën e Shqipërisë dhe transaksioni i anasjelltë)	350	
Komision (2) procesimi për operacionet DVP (marrëveshje riblerjeje/të anasjella riblerjeje dhe transaksioni i anasjelltë të ndryshme nga ato me Bankën e Shqipërisë)	200	
Komision procesimi për operacionet FOP (transfertat e portofolit, transaksionet midis llogarisë vetjake të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe llogarisë së një pjesëmarrësit të tërthortë që është klient i të njëjtit pjesëmarrës së drejtpërdrejtë, transaksionet midis dy pjesëmarrësve që kanë të njëjtin agjent shlyerës në AIPS, ekzekutimi i kolateralit, zëvendësimi i titullit në një marrëveshje riblerjeje, transaksionet për të plotësuar kërkesën për marzhin e ruajtjes së vlerës së titullit të tregtuar nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes)	350	
Komision për procesimin e rezultateve të tregut primar (emetim, maturim, ankand rihapjeje, ankand për blerjen mbrapsht të titullit)	200	
Komision për operacionet e netimit sipas modelit DVP2 për transaksionet e tregut primar	150	
Komision për procesimin e pagesës së interesave të përfituara nga investimi në titujt	1200	
Komision për procesimin e marrëveshjeve të kolateralit financiar (regjistrimi i kolateralit, lirimi i kolateralit)	350	
Komision për kthimin e kuponave nga rishitësi tek riblerësi në një marrëveshje repo/reverse repo	350	
Komision për riciklimin e transaksioneve të tregut primar	0 (zero)	
Komision për procesimin e operacioneve që rrjedhin nga thirrja e titujve, nga ankandet e marrëveshjeve të riblerjes/ të anasjella riblerjeje të Ministrisë së Financave, nga taksimi i titujve	0 (zero)	
C. Komisione të tjera		
Përgatitja e raporteve sipas kërkesës specifike	Për t'u vlerësuar në bazë të kërkesës specifike	
Komisione për trajnimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për certifikimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për pajisjen e aksesit në sistemit AFISaR	3 (tre) për pjesëmarrës falas, të tjerat me pagesë sipas koston së pajisjes	
D. Zbritjet për të inkurajuar procesimin		
Për vëllimin e procesuar	0 (zero)	
Për kohën e procesimit	0 (zero)	

* Ky komision faturohet dhe mbledhet nga pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë dhe më pas i transferohet Bankës së Shqipërisë.



SHTOJCA 10/1
INFORMACION MBI BURSËN E TITUJVE

1. Informacion i përgjithshëm

Emri i institucionit: _____

Përfaqësuesi ligjor: _____

Rezidenca: Rezident Jorezident ☐ ☐

Kodi BIC _____

Adresa: _____

E-mail: _____

Taksimi në burim: Po Jo ☐ ☐

Në qoftë se “Po”, norma e taksës në përqindje _____ e vërtetuar me dokumentin bashkëngjitur.

Mënyra e komunikimit: VPNSWIFT ☐ ☐

II. Karakteristika në lidhje me operimin e sistemit

1. Licencë për kujdestar/komisioner të titujve: Po Jo ☐ ☐

Në qoftë se përgjigjja është “Po”, ju lutem bashkëngjitni dokumentin që e vërteton.

2. Licencë për Bursë Titujsh Po Jo ☐ ☐

Në qoftë se përgjigjja është “Po”, ju lutem bashkëngjitni dokumentin që e vërteton

3. Konfirmimi për përputhjen e mesazheve: Po Jo ☐ ☐4. Keni llogari në sistemin AIPS: Po Jo ☐ ☐

Kontaktet

Person kontakti për çështje/probleme të operimit të sistemit		
Person kontakti për biznesin		
Emër, mbiemër		
Detyra që mbulon		
Telefon		
Celular		
E-mail		
Person kontakti për IT-në		
Emër, mbiemër		
Detyra që mbulon		
Telefon		
Celular		
E-mail		

Nënshkrimi: _____, datë: _____

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij formulari jap pranimin për përdorimin e të dhënave, në funksion të operimit të sistemit AFISaR.



SHTOJCA 12
ANËTARËSIMI NË AFISaR I NJË
PJESËMARRËSI TË DREJTPËRDREJTË
DHE BURSËN E TITUJVE

Fazat e anëtarësimit

I. Testimi dhe trajnimi

II. Përgatitja e dokumentacionit

III. Implementimi dhe kalimi në *live*

I. Testimi dhe trajnimi

1. Testimi i VPN:

a) instalimi dhe konfigurimi i VPN-së dhe lidhjes me FTP server në ambientet e institucionit kandidat;

b) përgatitja e kërkesës për përdorues në VPN dhe FTP server nga institucioni kandidat;

c) krijimi i përdoruesve të VPN-së dhe FTP-së server nga administratori;

d) testimi i VPN-së dhe lidhjes me FTP server nga institucioni kandidat dhe administratori.

2. Testimi i SWIFT:

a) në rast se institucioni do të përdorë shërbimin SWIFTNet FIN për shkëmbimin e transaksioneve me sistemin AFISaR, paraprakisht duhet të shkëmbejë autorizimet RMA me Bankën e Shqipërisë;

b) shkëmbimi i disa mesazheve test me anë të shërbimit SWIFTNet FIN test midis institucionit kandidat dhe administratorit.

3. Trajnimi/Testimi në sistemin AFISaR për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë dhe Bursën e Titujve me akses në VPN:

a) nga institucioni pjesëmarrës do të paraqitet kërkesa për përdorues në sistemin AFISaR test;

b) nga administratori përgatiten pajisjet e sigurisë, të cilat iu dorëzohen pjesëmarrësve dhe krijohen gjithashtu, përdoruesit në ambientin test të AFISaR;

c) Administratori do të trajnojë dy deri në tre punonjës të institucionit kandidat për funksionalitetin e sistemit AFISaR;

d) institucioni kandidat, në bashkëpunim me administratorin, do të ekzekutojë dokumentin e testimit dhe do ta firmosin atë.

II. Përgatitja e dokumentacionit për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë dhe Bursën e Titujve me akses në VPN:

a) Institucioni kandidat do të përgatisë “Rregullat dhe procedurat e brendshme të funksionimit të AFISaR”, në përputhje me këtë rregullore;

b) Dokumentacioni i përfunduar do të dorëzohet pranë administratorit për aprovim;

c) Administratori bën vërejtjet/modifikimet e saj, nëse bie ndesh me këtë rregullore dhe/ose të tjera rregullore të administratorit, të cilat ky i fundit ia paraqet institucionit kandidat;

d) Institucioni kandidat sjell variantin përfundimtar të “Rregullave dhe procedurave të brendshme të funksionimit të AFISaR”, ku reflektohen modifikimet sipas shkronjës c.

III. Implementimi dhe kalimi në Sistemin AFISaR *live* për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë dhe Bursën e Titujve me akses në VPN:

a) Përgatitja dhe dorëzimi i certifikatës së pjesëmarrjes nga administratori për institucionin kandidat;

b) Nënshkrimi i kontratës tip të pjesëmarrjes ndërmjet administratorit dhe institucionit pjesëmarrës, sipas shtojcës 1 ose shtojcës 1/1;

c) Pjesëmarrësi përgatit dhe dorëzon pranë administratorit “Informacion për pjesëmarrësin e drejtpërdrejtë”, shtojca 10 ose “Informacion mbi Bursën e Titujve”, shtojca 10/1;

d) Pjesëmarrësi plotëson dhe dorëzon pranë administratorit “Kërkesën për pajisje sigurie dhe përdorues në ambientin *live*”, shtojca 19;

e) Pjesëmarrësi plotëson dhe dorëzon pranë administratorit “Kërkesën për ndryshime në rrjetin VPN”, shtojca 19;

f) Pjesëmarrësi plotëson dhe dorëzon pranë administratorit “Kërkesën për krijim përdoruesi në sistemin FTP-AFISaR”, shtojca 19, pas miratimit të kërkesave nga administratori, krijohet pjesëmarrësi në AFISaR, përgatiten pajisjet e sigurisë me certifikatat e përdoruesve, krijohen përdoruesit në ambientin AFISaR *live*, krijohen përdoruesit në VPN, i dorëzohen pajisjet e sigurisë pjesëmarrësit;

g) Administratori përcakton ditën e kalimit *live* të pjesëmarrësit dhe njofton me *e-mail* të gjithë pjesëmarrësit e AFISaR;

h) Kalimi në *live*.

IV. Implementimi dhe kalimi në Sistemin AFISaR *live* për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë dhe Bursën e Titujve me akses në SWIFT:

a) Pjesëmarrësi dorëzon pranë administratorit “Informacion për pjesëmarrësin e drejtpërdrejtë”, shtojca 10 ose “Informacion mbi Bursën e Titujve”, shtojca 10/1;



b) Nënshkrimi i kontratës tip të pjesëmarrjes ndërmjet administratorit dhe institucionit pjesëmarrës, sipas shtojcës 1 ose shtojcës 1/1;

c) Administratori përcakton ditën e kalimit *live* të pjesëmarrësit dhe njofton me *e-mail* të gjithë pjesëmarrësit e AFISaR;

d) kalimi në *live*.

VENDIM

Nr. 72, datë 6.12.2017

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PLANET E RIMËKËMBJES SË BANKAVE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të nenit 7, pika 7, nenit 8, pika 9 dhe nenit 11, pika 6 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për planet e rimëkëmbjes së bankave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Me hyrjen në fuqi të rregullores së miratuar me këtë vendim, shfuqizohet udhëzimi “Mbi Planet e Rimëkëmbjes”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 26.02.2014.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Gent Sejko

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave mbikëqyrëse për planet e rimëkëmbjes së bankave dhe të grupeve bankare, lidhur me:

a) përmbajtjen e planeve të rimëkëmbjes dhe të planeve të thjeshtuara të rimëkëmbjes, mënyrën dhe afatin për paraqitjen dhe përditësimin e tyre;

b) kuadrin minimal të treguesve cilësorë dhe sasiorë, që përfshihen në planet e rimëkëmbjes; si dhe

c) kriteret minimale mbi të cilat kryhet vlerësimi i planeve të rimëkëmbjes nga Banka e Shqipërisë.

Neni 2 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3 Baza juridike

1. Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) nenit 7, pika 7, nenit 8, pika 9 dhe nenit 11, pika 6 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”).

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 4 dhe kreun II, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:



a) “masa të rimëkëmbjes” është tërësia e veprimeve (apo strategjive) të përfshira në planin e rimëkëmbjes, që duhet të ndërmerren nga banka, për të rivendosur pozicionin financiar, në rast të një përkeqësimi të konsiderueshëm të gjendjes financiare të bankës ose grupit bankar;

b) “ndryshim i rëndësishëm” është çdo ndryshim që mund të ndikojë në aftësinë e bankës ose të çdo subjekti të grupit bankar, për të zbatuar planin e rimëkëmbjes apo për të zbatuar një ose disa nga masat e rimëkëmbjes, të parashikuara në planin e rimëkëmbjes;

c) “pengesë e rëndësishme (materiale)” është çdo faktor që mund të ndikojë negativisht mbi zbatimin në kohë të masës së rimëkëmbjes, duke përfshirë në veçanti, rreziqet ligjore, operacionale, të biznesit, financiare dhe reputacionale;

d) “shërbime kritike” janë operacionet /veprimtaritë/shërbimet e kryera për një (shërbim i dedikuar) ose më shumë njësi biznesi ose subjekte (shërbime të përbashkëta) brenda grupit, të cilat janë të nevojshme për të siguruar një ose më shumë funksione kritike;

e) “subjekt i rëndësishëm i grupit ose degë e rëndësishme e bankës” është një subjekt (person juridik) ose degë, që plotëson të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

i) kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në të ardhurat e grupit ose bankës të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, në financimin e tij/saj ose zotëron një pjesë të rëndësishme të aktiveve, pasiveve ose kapitalit;

ii) kryen veprimtari kryesore për grupin ose bankën;

iii) kryen në mënyrë të përqendruar, funksione bazë operacionale, të administrimit të rrezikut ose funksione administrative, për grupin ose bankën;

iv) mbart rreziqe kryesore, të cilat sipas skenarit të përkeqësimit të gjendjes financiare, mund të rrezikojnë qëndrueshmërinë e grupit bankar ose të bankës;

v) shitja ose likuidimi i të cilit/cilës mund të ekspozojë bankën ose grupin në tërësi ndaj rreziqeve të rëndësishme;

vi) është i rëndësishëm për stabilitetin financiar të vendit;

f) “Ngjarje sistematike” - nënkupton një ngjarje që rrezikon të ketë pasoja të rënda negative për sistemin financiar ose ekonominë reale;

g) “Ngjarje specifike (idiosyncratic)” - nënkupton një ngjarje që rrezikon të ketë pasoja të rënda negative vetëm për bankën ose grupin bankar;

h) “*Stress-test* i anasjelltë”- është *stress-test*-i i bankës, i cili bazohet në identifikimin e rezultatit të paracaktuar dhe më pas shqyrton/vlerëson skenarët dhe rrethanat që mund të shkaktojnë këtë rezultat;

i) “Banka me rëndësi sistematike”- janë bankat e licencuara dhe që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara si të tilla, sipas vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë, për qëllime të kësaj rregulloreje;

j) “Metoda e parametrave të përshkallëzuar” (*progressive metrics*) - është metoda e përcaktimit të disa niveleve për treguesit sasiorë, duke marrë në konsideratë edhe oreksin/tolerancën ndaj rrezikut, derisa të arrihet kufiri i treguesit për aktivizimin e planit të rimëkëmbjes.

Neni 5

Kërkesa të përgjithshme

1. Banka harton dhe përditëson planin e rimëkëmbjes, të paktën një herë në vit, duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme që nga paraqitja (rishikimi) e fundit e planit, në profilin e rrezikut të bankës, kushtet e tregut dhe çdo faktor tjetër që ndikon në masat e rimëkëmbjes të propozuara në plan.

2. Banka, gjatë përgatitjes së planit të rimëkëmbjes, nuk merr në konsideratë mundësinë e mbështetjes financiare publike të jashtëzakonshme.

3. Banka përcakton në planin e rimëkëmbjes, strukturat përgjegjëse, proceset e nevojshme, kushtet e vënies në zbatim të planit dhe procedurat që sigurojnë zbatimin në kohë të masave të rimëkëmbjes.

4. Banka përcakton strukturën/njësinë e administrimit të rrezikut, si njësinë përgjegjëse për koordinimin e procesit të hartimit të planit brenda bankës, monitorimin e treguesve, përgatitjen e skenarëve dhe kryerjen e *stress-test*-eve të planit të rimëkëmbjes. Kjo njësi është përgjegjëse edhe për raportimin në Këshillin Drejtues mbi procesin e hartimit, nevojën për



përditësim dhe zbatimin e planit të rimëkëmbjes, mbi vlerat e treguesve të përzgjedhur dhe mbi rezultatet e *stress-test*-eve të planit të rimëkëmbjes.

5. Banka, në varësi të natyrës, madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë së saj, ndan rolin e personave përgjegjës për hartimin e planit të rimëkëmbjes, nga ai i personave që janë përgjegjës për kryerjen e *stress-test*-eve të planit të rimëkëmbjes.

6. Banka nuk mund të përfundojë me të tretët marrëveshje për të transferuar plotësisht procesin e hartimit të planit të rimëkëmbjes.

7. Banka identifikon në planin e rimëkëmbjes, një numër të mjaftueshëm masash rimëkëmbjeje të zbatueshme, me qëllim përballimin e ngjarjeve specifike dhe sistematike, për të siguruar rikthimin e saj në një gjendje të qëndrueshme.

8. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me autoritetet e huaja mbikëqyrëse dhe me bankat e huaja, që kanë hapur degën ose filialin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim koordinimin e masave të planit të rimëkëmbjes, në kuadër të planeve të grupit bankar, pjesë e të cilit është subjekti.

KREU II PËRMBAJTJA E PLANIT TË RIMËKËMBJES

Neni 6

Struktura e planit të rimëkëmbjes

1. Plani i rimëkëmbjes i hartuar nga banka përmban minimalisht:

- a) një përmbledhje ekzekutive të elementeve kryesore të planit të rimëkëmbjes;
- b) informacion të detajuar mbi elementet e mëposhme:
 - i) drejtimin e bankës;
 - ii) treguesit e rimëkëmbjes;
 - iii) analizën strategjike;
 - iv) masat e rimëkëmbjes;
 - v) skenarët;
 - vi) planin e komunikimit dhe informimit;
 - vii) analizën e masave parapërgatitore.

Neni 7

Përmbledhja ekzekutive e planit të rimëkëmbjes

1. Banka harton përmbledhjen ekzekutive të planit, e cila paraqet në mënyrë të qartë

informacionin mbi aftësinë e saj për t'u rimëkëmbur, në rastet e një situatë të përkeqësuar, si dhe i mundëson Bankës së Shqipërisë vlerësimin e përgjithshëm të masave të rimëkëmbjes.

2. Përmbledhja ekzekutive e elementeve kryesore të planit të rimëkëmbjes përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një përmbledhje të çdo ndryshimi të rëndësishëm në bankë, në grupin bankar apo në planin e rimëkëmbjes, që nga koha e paraqitjes së planit të fundit për shqyrtim në Bankën e Shqipërisë;

b) një përmbledhje të planit të rimëkëmbjes mbi drejtimin e bankës, duke përfshirë edhe një përmbledhje të komenteve dhe rekomandimeve të këshillit drejtues, të kontrollit të brendshëm dhe të komitetit të rrezikut (në rast se ekziston në strukturën e bankës një komitet i tillë), për këtë qëllim;

c) një përshkrim të treguesve të rimëkëmbjes;

d) një përmbledhje të analizës strategjike të planit të rimëkëmbjes, duke përfshirë edhe një përmbledhje të kapacitetit/aftësisë së përgjithshme për t'u rimëkëmbur;

e) një përmbledhje të skenarëve;

f) një përmbledhje të planit të komunikimit dhe informimit;

g) një përmbledhje të masave parapërgatitore, të përcaktuara në planin e rimëkëmbjes.

Neni 8

Drejtimi i bankës

1. Banka, në seksionin e planit të rimëkëmbjes mbi drejtimin, përfshin një përshkrim të detajuar të elementeve të mëposhtme:

a) roli dhe funksionet e personave përgjegjës për përgatitjen, zbatimin dhe përditësimin e çdo seksioni të planit;

b) emri i personit përgjegjës për të ndjekur përditësimin e planit të rimëkëmbjes;

c) përshkrimi i procesit të përditësimit të planit të rimëkëmbjes, me qëllim që plani t'u përgjigjet ndryshimeve të rëndësishme që ndikojnë bankën ose grupin bankar;

d) mënyra e integritetit të planit në sistemin e administrimit të rrezikut të bankës ose të grupit bankar;

e) nëse banka është pjesë e një grupi bankar, një përshkrim i marrëveshjeve brenda grupit, me



qëllim sigurimin e koordinimit dhe përputhshmërisë (konsistencës) së masave të rimëkëmbjes në nivel grupi;

f) procedurat që rregullojnë procesin e miratimit të planit të rimëkëmbjes, duke përfshirë edhe rishikimin e tij nga njësi e kontrollit të brendshëm dhe komiteti i rrezikut (në rast se ekziston në strukturën e bankës një komitet i tillë), si dhe vlerësimin dhe miratimin nga këshilli drejtues i bankës;

g) kushtet dhe procedurat e nevojshme për të siguruar zbatimin në kohë të masave të rimëkëmbjes, duke përfshirë minimalisht:

i) një përshkrim të procesit të brendshëm të përshkallëzimit dhe të vendimmarrjes, që zbatohet kur arrihen treguesit, për të vendosur se cila masë rimëkëmbjeje duhet të zbatohet, në përgjigje të përkeqësimit të gjendjes financiare, duke përfshirë të paktën:

- rolin, funksionet dhe përgjegjësitë e personave të përfshirë në këtë proces, si dhe, nëse në këtë proces është përfshirë edhe ndonjë komitet, rolin, funksionet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të komitetit;

- procedurat që duhet të ndiqen;

- afatin kohor për vendimin mbi zbatimin e masave të rimëkëmbjes, si dhe kohën dhe mënyrën e informimit të Bankës së Shqipërisë, mbi arritjen e treguesve;

ii) një përshkrim të detajuar të treguesve, që pasqyrojnë ndikimin e mundshëm në nivelin e kapitalit, situatën e likuiditetit, përfitueshmërinë dhe profilin e rrezikut të bankës ose subjekteve të përfshirë në planin e rimëkëmbjes;

h) përputhshmëria me sistemin e administrimit të rrezikut të bankës ose të grupit bankar, duke përfshirë edhe një përshkrim të kufijve përkatës të paralajmërimit të hershëm, të cilët janë pjesë e procesit të brendshëm të administrimit të rrezikut të bankës ose grupit dhe sigurojnë informacion për organet drejtuese mbi mundësinë e arritjes së treguesve;

i) sistemet e administrimit të informacionit, duke përfshirë edhe një përshkrim të mënyrës së sigurimit të informacionit të nevojshëm, në kohë dhe në mënyrë të besueshme, për zbatimin e masave të rimëkëmbjes.

NËNKREU I TREGUESIT E RIMËKËMBJES

Neni 9

Kuadri i treguesve të rimëkëmbjes

1. Banka harton kuadrin e treguesve të rimëkëmbjes, si pjesë të rëndësishme të planit të rimëkëmbjes.

2. Treguesit e rimëkëmbjes janë tregues sasiore dhe tregues cilësorë.

3. Banka, në kuadrin e treguesve të rimëkëmbjes, përfshin të gjithë treguesit sipas kategorive të aneksit nr. 1 të kësaj rregulloreje:

- a) tregues të kapitalit;
- b) tregues të likuiditetit;
- c) tregues të përfitueshmërisë;
- d) tregues të cilësisë së aktiveve;
- e) tregues të tregut dhe makroekonomikë.

4. Banka, në rastet kur nuk përfshin në planin e rimëkëmbjes, tregues të tregut dhe makroekonomikë, argumenton se këta tregues nuk kanë lidhje me strukturën ligjore, profilin e rrezikut, madhësinë dhe/ose kompleksitetin e saj.

5. Banka mund të përfshijë në planin e rimëkëmbjes edhe treguesit shtesë, sipas listës ilustruese të paraqitur në aneksin nr. 2 të kësaj rregulloreje ose tregues të tjerë, sipas vlerësimit të vetë bankës.

6. Banka, në hartimin e kuadrit të treguesve të rimëkëmbjes, siguron që ky kuadër:

a) përshtatet me modelin e biznesit dhe strategjinë e bankës, si dhe identifikon dobësitë kryesore që mund të ndikojnë në gjendjen financiare të bankës dhe që sjellin aktivizimin ose jo, të planit të rimëkëmbjes;

b) është i mjaftueshëm për madhësinë, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut të bankës, si dhe në veçanti, numri i treguesve që do të përfshihen në plan është i mjaftueshëm për të paralajmëruar/sinjalizuar në kohë organet drejtuese të bankës, mbi përkeqësimin e situatës;

c) përcakton momentin, në të cilin banka duhet të vendosë, nëse duhet të ndërmarë ose jo një veprim, siç përcaktohet në planin e rimëkëmbjes;

d) është i integruar dhe përputhet me sistemin e administrimit të rrezikut, duke përfshirë treguesit ekzistues të planit të emergjencës për likuiditetin dhe kapitalin, planit të vazhdimësisë



së veprimtarisë, si dhe procedurat e përshkallëzimit dhe të vendimmarrjes;

e) përfshin edhe tregues të orientuar nga e ardhmja/perspektiva (*forward-looking*).

7. Banka, gjatë përcaktimit të treguesve sasiore të planit të rimëkëmbjes, përdor metodën e parametrave të përshkallëzuar, me qëllim që të sigurohet në çdo kohë informacioni për organet drejtuese, mbi mundësinë e arritjes së këtyre treguesve.

8. Banka i rikalibron treguesit e planit të rimëkëmbjes, të paktën një herë në vit dhe sa herë është e nevojshme, në mënyrë që të mundësojë sinjalizimin në kohë, duke konsideruar edhe madhësinë dhe shpejtësinë e thyerjes së kufijve të treguesve.

9. Banka argumenton/shpjegon mënyrën e kalibrimit dhe të përcaktimit të kufijve të këtyre treguesve.

10. Banka siguron që sistemet e administrimit të informacionit, mundësojnë lehtësisht monitorimin në vazhdimësi të treguesve nga ana e vetë bankës dhe paraqitjen në kohë të tyre (treguesve), sa herë që kërkohen nga Banka e Shqipërisë.

Neni 10

Treguesit e kapitalit

1. Banka, në përcaktimin/përzgjedhjen e treguesve të kapitalit, siguron që këta tregues të identifikojnë në vazhdimësi çdo përkeqësim të konsiderueshëm aktual apo që mund të ndodhë në të ardhmen, në nivelin dhe cilësinë e kapitalit.

2. Banka, gjatë përcaktimit/përzgjedhjes së treguesve të kapitalit, mban parasysh se kapaciteti i këtyre treguesve për të reaguar në kohën e duhur, mund të jetë më i ulët se për disa tregues të tjerë, si dhe disa masa për rivendosjen e nivelit të kapitalit të bankës mund të kërkojnë periudha më të gjata ekzekutimi apo të kenë ndjeshmëri më të madhe ndaj tregut dhe kushteve të tjera. Banka shqyrton mënyrat për të adresuar këto problematika, në veçanti, nëpërmjet krijimit të projeksioneve të kapitalit të orientuara nga e ardhmja (*forward-looking*), duke marrë në konsideratë afatin e maturimit kontraktual të instrumenteve të rëndësishme të kapitalit.

3. Banka përfshin treguesit e kapitalit edhe në Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (PVB MK), si dhe në sistemin e saj të administrimit të rrezikut.

4. Banka kalibron kufijtë për treguesit e kapitalit, duke u bazuar në profilin e rrezikut të saj dhe në kohën e nevojshme për aktivizimin e masave të rimëkëmbjes, duke marrë parasysh kapacitetin e rimëkëmbjes, si rezultat i këtyre masave dhe se sa shpejt mund të ndryshojë niveli i kapitalit, duke konsideruar rrethanat individuale të bankës.

5. Banka kalibron në nivele të mjaftueshme kufijtë për treguesit e kapitalit, me qëllim që të sigurohet një kohë e mjaftueshme për aktivizimin e masave të rimëkëmbjes, për të siguruar ruajtjen e niveleve minimale të kërkuara të kapitalit dhe të kërkesave shtesë për rreziqet e tjera.

Neni 11

Treguesit e likuiditetit

1. Banka përcakton/përzgjedh treguesit e likuiditetit, të cilët i sigurojnë asaj sinjalizimin në kohë, për një përkeqësim aktual apo të mundshëm të kapacitetit të saj, për të plotësuar nevojat aktuale dhe të parashikuara për likuiditet dhe financim, për të siguruar zbatimin e kërkesave minimale rregullatore, përfshirë edhe kërkesat shtesë për likuiditet.

2. Treguesit e likuiditetit u referohen nevojave afatshkurtra e afatgjata të bankës për likuiditet dhe financim dhe përfshijnë edhe mbështetjen e bankës në tregun ndërbankar dhe në depozitat e klientëve, sipas monedhave të ndryshme.

3. Banka integron dhe përshtat treguesit e likuiditetit, me strategjitë, politikat, proceset dhe sistemet e saj, si dhe me sistemin e administrimit të rrezikut.

4. Treguesit e likuiditetit konsiderojnë gjithashtu edhe nevoja të tjera të mundshme për likuiditet dhe financim, të tilla si marrëveshjet e financimit brenda grupit dhe zërat jashtë bilancit.

5. Banka kalibron kufijtë për treguesit e likuiditetit, bazuar në profilin e rrezikut të saj, kohën e nevojshme për të aktivizuar masat e rimëkëmbjes dhe në kapacitetin e rimëkëmbjes.

Neni 12

Treguesit e përfitueshmërisë

1. Treguesit e përfitueshmërisë përfshijnë aspektet më të rëndësishme që lidhen me burimet kryesore të të ardhurave dhe shpenzimeve të bankës, luhatja e të cilave mund të çojë në një përkeqësim të shpejtë të gjendjes



financiare të saj, për shkak të ndikimit në kapitalin e bankës.

2. Banka përfshin në këtë kategori edhe tregues që u referohen humbjeve që rrjedhin nga rreziku operacional ose rreziku i kredisë, të cilat mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në pasqyrën e fitimit dhe humbjes.

Neni 13

Treguesit e cilësisë së aktiveve

1. Banka përcakton treguesit e cilësisë së aktiveve, të cilët i sigurojnë asaj sinjalizimin në kohë, për rastet e përkeqësimit të cilësisë së aktiveve, që mund të sjellin ndërmarrjen nga banka të një veprimi të përshkruar në planin e rimëkëmbjes.

2. Treguesit e cilësisë së aktiveve mund të përfshijnë si gjendjen (tepricën), edhe ecurinë e ekspozimeve me probleme, me qëllim që të sigurojnë identifikimin e nivelit dhe të dinamikës së tyre.

3. Treguesit e cilësisë së aktiveve përfshijnë edhe ekspozimet jashtë bilancit që lidhen me kreditë me probleme dhe ndikimin e tyre në cilësinë e aktiveve.

Neni 14

Treguesit e tregut dhe makroekonomikë

1. Treguesit e tregut identifikojnë pritshmëritë e pjesëmarrësve të tregut për një përkeqësim të shpejtë të gjendjes financiare të bankës, që mund të çojë në vështirësi të sigurimit të financimit apo pjesëmarrjes në tregjet e kapitalit.

2. Banka, në përputhje me kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, mund të përfshijë në kategorinë e treguesve të tregut, koston e borxhit afatgjatë, përkeqësimin e vlerësimeve (afatshkurtra dhe/ose afatgjata), të cilat reflektojnë pritshmëritë e agjencive të vlerësimit, që çojnë në ndryshime të shpejta edhe në pritshmëritë e pjesëmarrësve të tregut mbi gjendjen financiare të bankës etj.

3. Treguesit makroekonomikë identifikojnë sinjale të përkeqësimit të kushteve ekonomike të vendit ku banka ushtron veprimtarinë ose të vendit ku ka përqendrim të ekspozimeve apo financimeve të saj.

4. Treguesit makroekonomikë të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, mund të përfshijnë tipologjitë e treguesve të mëposhtëm:

a) treguesit makroekonomikë gjeografikë, që lidhen me vende (juridiksione) të ndryshme ndaj të cilave banka është e ekspozuar, duke marrë në konsideratë edhe rreziqet që rrjedhin nga pengesat e mundshme ligjore;

b) treguesit makroekonomikë sektorialë, që lidhen me sektorët e veçantë më të mëdhenj të aktivitetit ekonomik, ndaj të cilëve banka është e ekspozuar.

NËNKREU II

ANALIZA STRATEGJIKE

Neni 15

Analiza strategjike

1. Banka, në analizën strategjike identifikon veprimtaritë kryesore (linjat kryesore të biznesit) dhe funksionet kritike, si dhe përcakton hapat kryesorë që ndiqen për të ruajtur vazhdimësinë e këtyre veprimtarive dhe të funksioneve kritike, në kushtet e një situatë të përkeqësimit të gjendjes financiare.

2. Banka, në analizën strategjike, përfshin elementet e mëposhtme:

a) një përshkrim të saj dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes; dhe

b) një përshkrim të masave të rimëkëmbjes.

Neni 16

Subjektet e planit të rimëkëmbjes

1. Banka, në përputhje me kërkesat e pikës 2, shkronja “a” të nenit 15 të kësaj rregulloreje, si pjesë të analizës strategjike, përgatit edhe një përshkrim të saj dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, i cili përmban informacionin e mëposhtëm:

a) një përshkrim të përgjithshëm të elementeve të mëposhtme për bankën dhe subjektet e grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes:

i) strategjia e biznesit dhe strategjia e rrezikut të tyre;

ii) modeli dhe plani i biznesit, së bashku me një listë të vendeve (juridiksioneve) kryesore ku ushtrorjnë veprimtarinë, duke përfshirë edhe nëpërmjet një subjekti të rëndësishëm të grupit ose dege të rëndësishme të bankës;



iii) veprimtaritë kryesore (linjat kryesore të biznesit) dhe funksionet kritike;

iv) procesi/metodologjia dhe parametrat për identifikimin e veprimtarive kryesore (linjave kryesore të biznesit) dhe të funksioneve kritike;

b) shpërndarjen e veprimtarive kryesore (linjave kryesore të biznesit) dhe të funksioneve kritike, ndërmjet degëve të rëndësishme të bankës dhe subjekteve të rëndësishme të grupit;

c) një përshkrim të detajuar të strukturës ligjore dhe financiare të bankës dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, së bashku me një përshkrim të ndërlidhjes brenda grupit dhe në veçanti një përshkrim të elementeve të mëposhtme:

i) të të gjitha ekspozimeve të rëndësishme ekzistuese dhe të marrëdhënieve të financimit brenda grupit, të flukseve të kapitalit midis subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, të garancive ekzistuese brenda grupit ose garancive që pritet të hyjnë në fuqi, në momentin kur aktivizohet plani i rimëkëmbjes;

ii) të ndërlidhjes operacionale, në lidhje me funksionet, të cilat janë të përqendruara në një subjekt të grupit ose degë të bankës, që janë të rëndësishme për funksionimin e subjekteve të tjera të grupit, degëve të bankës ose grupit bankar dhe veçanërisht, funksionet e centralizuara të teknologjisë së informacionit, funksionet e thesarit, funksionet e administrimit të rrezikut ose funksionet administrative;

iii) të çdo marrëveshjeje ekzistuese për mbështetje financiare brenda grupit, duke përfshirë palët e marrëveshjes, formën e mbështetjes financiare, si dhe kushtet për përfitimin e mbështetjes financiare.

d) një përshkrim të ndërlidhjes së jashtme, që përfshin minimalisht:

i) ekspozimet dhe detyrimet kryesore ndaj kundërpartive kryesore;

ii) produktet dhe shërbimet financiare kryesore, të ofruara nga banka dhe subjektet e grupit të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregjeve financiare;

iii) shërbimet kryesore që palët e treta ofrojnë ndaj bankës dhe subjekteve të grupit të përfshirë në planin e rimëkëmbjes.

Neni 17

Masat e rimëkëmbjes

1. Seksioni mbi masat e rimëkëmbjes, përfshin një listë të të gjitha masave të rimëkëmbjes, të identifikuara për t'iu përgjigjur skenarëve të përkeqësimit të gjendjes financiare, me qëllim ruajtjen ose rivendosjen e qëndrueshmërisë dhe të pozicionit financiar të bankës dhe subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes.

2. Banka, në listën e masave të rimëkëmbjes, përveç masave të natyrës së jashtëzakonshme, përfshin edhe masa, të cilat mund të merren në kushte normale të veprimtarisë të bankës dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes.

3. Masat e rimëkëmbjes përfshijnë edhe ato masa, të cilat mund të kërkojnë ndryshime në natyrën e biznesit të bankës ose subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes.

4. Banka, për çdo masë rimëkëmbjeje, përcakton afatin e pritshëm kohor për zbatimin e saj.

5. Masat e identifikuara nga banka duhet t'i përkasin minimalisht njëres nga kategoritë e mëposhtme:

a) tërësisë së veprimeve që lidhen me kapitalin dhe likuiditetin, të cilët kanë si objektiv kryesor sigurimin e qëndrueshmërisë së funksioneve kritike dhe të veprimtarive kryesore (linjave kryesore të biznesit), me qëllim ruajtjen dhe/ose rivendosjen e qëndrueshmërisë dhe të pozicionit financiar të bankës ose të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes;

b) marrëveshjeve dhe masave, të cilat kanë si objektiv kryesor ruajtjen ose rivendosjen e nivelit të kapitalit rregullator të bankës ose të grupit, nëpërmjet rikapitalizimit të jashtëm dhe masave të brendshme, me qëllim përmirësimin e nivelit të kapitalit të bankës ose subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes;

c) marrëveshjeve dhe masave, të cilat sigurojnë se banka ose subjektet e grupit bankar që përfshihen në planin e rimëkëmbjes, kanë akses të mjaftueshëm në burimet e financimit në raste emergjence, për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë dhe për të përmbushur detyrimet që maturohen (këto masa përfshijnë masa të



jashtme, si dhe aty ku është e mundur, masa që synojnë transferimin e likuiditetit brenda grupit);

d) marrëveshjeve dhe masave për të reduktuar rrezikun ose për të ristrukturuar veprimtaritë (linjat e biznesit), duke përfshirë aty ku është e mundur, një analizë të mundësive të shitjes së aktiveve, subjekteve të grupit ose linjave të biznesit;

e) marrëveshjeve dhe masave, të cilat kanë si qëllim kryesor arritjen e një ristrukturimi nga vetë banka të borxhit/detyrimeve, me kusht që të mos shkaktojë një ngjarje aktivizuese (*trigger event*) të paafëtisë paguese, të zgjidhjes së marrëveshjeve ekzistuese, të uljes të nivelit të vlerësimit të bankës ose të një ngjarjeje të ngjashme me to.

6. Banka, në rastet kur masat e rimëkëmbjes nuk përfshijnë ndonjë nga veprimet, marrëveshjet apo masat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, paraqet një shpjegim në këtë seksion të planit të rimëkëmbjes, se këto veprime, marrëveshje apo masa, janë marrë në konsideratë në mënyrë të mjaftueshme nga banka mëmë ose subjekte të tjera të grupit që kanë përgatitur dhe paraqitur planin, në autoritetin mbikëqyrës të vendit ku ushtrojnë veprimtarinë.

Neni 18

Vlerësimi i efektit të masave të rimëkëmbjes

1. Çdo masë rimëkëmbjeje përfshin edhe një vlerësim të efektit të saj, në veçanti, një përshkrim të detajuar të procesit të përcaktimit të vlerës dhe tregtueshmërisë së veprimtarive kryesore (linjave kryesore të biznesit), operacioneve dhe aktiveve të bankës dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, vlerësimi i efektit të masës së rimëkëmbjes përfshin edhe elementet e mëposhtme:

a) një vlerësim të efektit financiar dhe operacional, që përcakton ndikimin e pritshëm në aftësinë paguese, likuiditetin, përfitueshmërinë dhe veprimtarinë e bankës dhe të subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes. Aty ku është e mundur, vlerësimi duhet të identifikojë qartë subjektet e ndryshme të grupit, që mund të ndikohen nga masa ose që do të përfshihen në zbatimin e saj;

b) një vlerësim të efektit të jashtëm dhe të pasojave sistematike, që përcakton ndikimin mbi funksionet kritike që kryhen nga banka ose subjektet e grupit bankar, të përfshirë në planin e

rimëkëmbjes, si dhe efektin mbi aksionarët, klientët dhe kundërpasuritë;

c) supozimet e përdorura për qëllime të vlerësimit të pikave “a” dhe “b”, duke përfshirë tregtueshmërinë e aktiveve ose sjelljen e bankave dhe subjekteve të tjera financiare.

Neni 19

Vlerësimi i zbatueshmërisë së masave të rimëkëmbjes

1. Çdo masë rimëkëmbjeje, duhet të përmbajë edhe një vlerësim të zbatueshmërisë në praktikë të saj, që përfshin:

a) një vlerësim të rrezikut të lidhur me masën e rimëkëmbjes, duke u bazuar në ndonjë eksperiencë të mëparshme të zbatimit të kësaj mase ose të një mase të barasvlershme me të;

b) një analizë dhe përshkrim të detajuar të çdo pengese të rëndësishme për zbatimin efektiv dhe në kohë të planit dhe një përshkrim të mënyrës se si do të kapërcehen këto pengesa.

Neni 20

Vazhdimësia e veprimtarisë së bankës

1. Banka, për çdo masë rimëkëmbjeje, kryen edhe një vlerësim të mënyrës së sigurimit të vazhdimësisë së veprimtarisë, në rastet kur do të zbatohet kjo masë rimëkëmbjeje.

2. Vlerësimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, konsideron:

a) marrëveshjet apo masat e nevojshme për sigurimin e një aksesit të vazhdueshëm në infrastrukturën e tregjeve financiare;

b) marrëveshjet apo masat e nevojshme për sigurimin e funksionimit të vazhdueshëm të proceseve operacionale të bankës dhe të subjekteve të grupit, që përfshihen në planin e rimëkëmbjes, duke përfshirë infrastrukturën dhe shërbimet e teknologjisë së informacionit;

c) kohën e nevojshme për zbatimin dhe efektivitetin e planit të rimëkëmbjes;

d) efektivitetin e masave të rimëkëmbjes dhe mjaftueshmërinë e treguesve, në rastin e skenarëve të përkeqësimit të gjendjes financiare, që vlerësojnë efektin e çdo skenari mbi subjektet që përfshihen në planin e rimëkëmbjes, në veçanti, mbi kapitalin, likuiditetin, përfitueshmërinë, profilin e rrezikut dhe veprimtarinë e tyre.



3. Vlerësimi përcakton masat e rimëkëmbjes, që mund të jenë më të përshtatshme për një skenar të caktuar, bazuar në efektin e mundshëm dhe zbatueshmërinë e tyre.

4. Vlerësimi i bazuar në këtë informacion, duhet të përshkruajë kapacitetin e përgjithshëm të rimëkëmbjes të bankës ose subjekteve të grupit bankar që përfshihen në planin e rimëkëmbjes, duke përfshirë edhe shkallën në të cilën masat e rimëkëmbjes e lejojnë bankën ose subjektet e tjera të grupit të rimëkëmben, në rastet e skenarëve të përkeqësimit të gjendjes makroekonomike e financiare.

NËNKREU III SKENARËT

Neni 21 Skenarët

1. Banka harton të paktën tre skenarë, për një ngjarje sistemike, një ngjarje specifike dhe një kombinim të të dyjave.

2. Çdo skenar bazohet në ngjarje, të cilat përmbushin secilën prej kërkesave të mëposhtme:

a) kanë ndikim të rëndësishëm te banka ose grupi bankar, duke konsideruar minimalisht: modelin e biznesit dhe të financimit të bankës, veprimtaritë dhe strukturën e grupit, madhësinë ose ndërlidhjen e saj me bankat e tjera ose me sistemin financiar në tërësi dhe, në veçanti, dobësitë e identifikuar të bankës ose të grupit bankar;

b) mund të shkaktojnë paaftësi paguese të bankës ose të grupit, nëse nuk zbatohen masat e rimëkëmbjes në kohën e duhur; dhe

c) janë të jashtëzakonshme, por të mundshme për të ndodhur.

3. Çdo skenar përfshin një vlerësim të ndikimit të ngjarjeve, në të paktën një nga elementet e mëposhtme të bankës ose grupit:

a) kapitalin në dispozicion;

b) likuiditetin në dispozicion;

c) profilin e rrezikut;

d) përfitueshmërinë;

e) operacionet, duke përfshirë operacionet e pagesave dhe të shlyerjes;

f) reputacionin.

4. Banka përdor *stress-test*-in e anasjelltë, në rastet kur ndërton skenarë që parashikojnë ta çojnë bankën pranë një situatë të paaftësisë paguese, nëse nuk do të zbatoheshin me sukses masat e rimëkëmbjes.

5. Banka përcakton numrin e skenarëve, në përputhje me natyrën e veprimtarisë, madhësinë, ndërlidhjen me bankat e tjera dhe me sistemin financiar në tërësi, si dhe me modelin e saj të financimit.

6. Skenarët përfshijnë si ngjarje të pafavorshme që mund të ndodhin gradualisht, ashtu edhe ngjarje të pafavorshme që mund të ndodhin menjëherë.

7. Banka, në hartimin e skenarëve të bazuar në ngjarje sistemike, merr në konsideratë të paktën një prej ngjarjeve të mëposhtme:

a) vështirësi financiare/paaftësi paguese e bankave me rëndësi sistemike, që ndikojnë në stabilitetin financiar;

b) një rënie të likuiditetit në dispozicion, në tregun e huadhënies ndërbankare;

c) rritjen e rrezikut të vendit dhe rritjen e flukseve dalëse të kapitalit;

d) lëvizjet e pafavorshme në çmimin e aktiveve në një ose disa tregje;

e) përkeqësimin e treguesve makroekonomikë;

f) etj.

8. Banka, në hartimin e skenarëve të bazuar në ngjarje specifike, merr në konsideratë të paktën një prej ngjarjeve të mëposhtme:

a) vështirësi financiare/paaftësi paguese të:

i) kundërpartive të rëndësishme të bankës;

ii) grupit bankar, pjesë e të cilit është banka; dhe/ose

iii) bankës mëmë apo filialeve të saj;

b) dëmtimin e reputacionit të bankës ose grupit;

c) rritjen e flukseve dalëse të likuiditetit;

d) lëvizjen e pafavorshme në çmimet e aktiveve, të cilat kanë një peshë të rëndësishme në bilancin e bankës ose grupit;

e) humbjet e konsiderueshme nga aktiviteti i kredisë;

f) humbjet e konsiderueshme operacionale;

g) etj.

Neni 22

Plani i komunikimit dhe informimit

I. Plani i komunikimit dhe informimit është një plan i detajuar, i cili përfshin çështjet e mëposhtme:

a) përshkrimin e procesit të komunikimit të brendshëm me punonjësit e bankës;

b) përshkrimin e procesit të komunikimit të jashtëm, në veçanti me aksionarët dhe investitorët e tjerë, autoritetet mbikëqyrëse, kundërpartitë, tregjet financiare, depozituesit dhe publikun e gjerë;



c) përshkrimin e masave që do të ndërmerren për të administruar reagimet e mundshme negative të tregut dhe strukturat që do të angazhohen për administrimin e këtyre situatave;

d) përcaktimin e mënyrës së njoftimit dhe personave përgjegjës për informimin e Bankës së Shqipërisë, në kohën e duhur dhe në mënyrë të plotë, mbi ndodhjen e ngjarjeve që aktivizojnë planin e rimëkëmbjes, si dhe masat aktuale të rimëkëmbjes dhe përshkallëzimin e tyre të mundshëm.

2. Plani i komunikimit dhe informimit konsideron, nëse për ndonjë nga masat e rimëkëmbjes, nevojitet një komunikim specifik.

Neni 23

Masat parapërgatitore

1. Plani i rimëkëmbjes përfshin një analizë të çdo mase parapërgatitore, që është e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e planit të rimëkëmbjes ose për të përmirësuar efektivitetin e tij, si dhe një afat kohor për zbatimin e këtyre masave parapërgatitore.

2. Masa të tilla përfshijnë masat e nevojshme për të kaluar çdo pengesë, në zbatimin me efektivitet të masave të rimëkëmbjes, të cilat janë identifikuar në planin e rimëkëmbjes.

Neni 24

Kërkesa për planet e thjeshtuara të rimëkëmbjes

1. Bankat me rëndësi josistemike, përveç sa përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, zbatojnë të gjitha kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Bankat me rëndësi josistemike, nëse nuk kërkohet ndryshe nga Banka e Shqipërisë, paraqesin plane të thjeshtuara të rimëkëmbjes. Këto plane përmbajnë të gjithë informacionin e kërkuar në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, me përjashtim të:

a) kuadrin të treguesve: në të cilin banka përfshin të paktën një tregues nga çdo kategori e treguesve (siç përcaktohet në aneksin nr. 1 dhe/ose aneksin nr. 2);

b) skenarëve: banka zhvillon të paktën një skenar, i cili bazohet në një ngjarje specifike ose në një ngjarje sistemike.

KREU III

KËRKESA RAPORTUESE DHE MBIKËQYRËSE

Neni 25

Kërkesa raportuese dhe mbikëqyrëse

1. Bankat paraqesin planet e rimëkëmbjes pranë Bankës së Shqipërisë çdo vit, jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë të vitit, në të cilat përfshijnë informacionin cilësor dhe sasior sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe siç përcaktohet në aneksin nr. 3 dhe aneksin nr. 4 të saj.

2. Banka mbizotëruese në një grup bankar, paraqet planin e rimëkëmbjes së grupit bankar, sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni.

3. Banka e Shqipërisë vlerëson planet e rimëkëmbjes në përputhje me kërkesat e nënkreut I të këtij kreu.

4. Banka e Shqipërisë komunikon në mënyrë të vazhdueshme me bankat, si dhe kryen të gjitha vlerësimet e nevojshme në kuadrin e mbikëqyrjes nga jashtë dhe në vend, për t'u siguruar efektivisht mbi aftësinë e tyre për t'u rimëkëmbur në rast nevojë, si dhe mbi nivelin e gatishmërisë së tyre operacionale.

5. Banka e Shqipërisë u komunikon bankave rekomandimet e nevojshme për trajtimin e mangësive të identifikuara dhe përmirësimin e planeve të rimëkëmbjes, përcakton afatet për pasqyrimin e këtyre rekomandimeve, si dhe monitoron zbatimin e tyre.

NËNKREU I

VLERËSIMI I PLANEVE TË RIMËKËMBJES NGA AUTORITETI MBIKËQYRËS

Neni 26

Vlerësimi i përmbajtjes së planeve të rimëkëmbjes

1. Banka e Shqipërisë vlerëson nëse plani i rimëkëmbjes plotëson kërkesat ligjore në fuqi për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe kërkesat e kësaj rregulloreje, si dhe përmbajtjen dhe elementet e planit, duke marrë në konsideratë:

a) nëse plani përfshin të gjithë informacionin e kërkuar në ligjin "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme", si dhe në këtë rregullore;

b) nëse plani përmban informacion të përditësuar, i cili përfshin edhe të gjitha ndryshimet e rëndësishme të bankës ose të subjekteve të grupit,



në veçanti ndryshimet në strukturën ligjore, në strukturën organizative, në situatën ekonomike apo financiare, që nga koha e paraqitjes së fundit të planit të rimëkëmbjes;

c) nëse (aty ku është e zbatueshme) plani përfshin edhe një analizë të mënyrës dhe kohës së përdorimit nga ana e bankës ose e subjekteve të grupit, të lehtësirave të bankës qendrore dhe nëse janë identifikuar aktivet që klasifikohen si garanci të mundshme;

d) nëse plani i rimëkëmbjes parashikon një tërësi skenarësh për përqekësimin e gjendjes makroekonomike dhe financiare, të cilët lidhen me kushtet specifike të bankës ose subjekteve të grupit bankar të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, duke mbajtur parasysh kriteret dhe kërkesat e parashikuara në këtë rregullore;

e) nëse plani i rimëkëmbjes përmban një kuadër treguesish, i cili identifikon momentin kur banka duhet të ndërmarrë veprimet përkatëse të parashikuara në plan, duke mbajtur parasysh kriteret dhe kërkesat e parashikuara në këtë rregullore;

f) nëse (aty ku është e zbatueshme) plani përfshin edhe marrëveshjet për mbështetje financiare brenda grupit, në përputhje me kërkesat e ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme” dhe të kësaj rregulloreje;

g) nëse për secilin prej skenarëve për përqekësimin e gjendjes makroekonomike dhe financiare të parashikuar në plan, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, plani identifikon nëse ka:

i) pengesa për zbatimin e masave të rimëkëmbjes brenda grupit dhe për çdo subjekt të veçantë të tij, të përfshirë në plan;

ii) pengesa të rëndësishme praktike apo ligjore për transferimin e menjëhershëm të fondeve ose për shlyerjen e detyrimeve apo të aktiveve brenda grupit bankar.

Neni 27

Cilësia e planeve të rimëkëmbjes

1. Banka e Shqipërisë vlerëson cilësinë e planit të rimëkëmbjes, duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

a) qartësinë e planit të rimëkëmbjes, duke u fokusuar:

i) nëse plani i rimëkëmbjes është vetëshpjegues dhe është shkruar në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme;

Faqe | 11936

ii) nëse përkufizimet dhe përshkrimet janë të qarta dhe të qëndrueshme përgjatë gjithë planit;

iii) nëse supozimet dhe vlerësimet e bëra brenda planit të rimëkëmbjes, janë shpjeguar qartë;

iv) nëse referencat dhe anekset e planit të rimëkëmbjes e plotësojnë planin në mënyrë të tillë, që sigurojnë identifikimin e mundësive për të ruajtur apo rivendosur qëndrueshmërinë dhe pozicionin financiar të bankës apo subjekteve të grupit të përfshirë në planin e rimëkëmbjes;

b) përshatshmërinë e informacionit të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, nëpërmjet vlerësimit nëse informacioni përqendrohet në identifikimin e mundësive për të ruajtur apo rivendosur qëndrueshmërinë dhe pozicionin financiar të bankës apo të grupit bankar;

c) karakterin gjithëpërfshirës të planit të rimëkëmbjes, duke marrë parasysh në veçanti natyrën e biznesit të bankës ose të subjekteve të grupit të përfshirë në plan, madhësinë e tyre dhe ndërlidhjen me bankat dhe grupe të tjera, si dhe me sistemin financiar në përgjithësi dhe duke u fokusuar:

i) nëse plani i rimëkëmbjes siguron një nivel të mjaftueshëm detajimi në lidhje me informacionin e kërkuar në këtë rregullore;

ii) nëse plani i rimëkëmbjes përmban një tërësi masash dhe treguesish të rimëkëmbjes, sipas kriterëve dhe kërkesave të parashikuara në këtë rregullore;

d) përputhshmërinë (konsistencën) e brendshme të planit individual të rimëkëmbjes dhe të planit të grupit bankar.

Neni 28

Vlerësimi i zbatueshmërisë së planeve të rimëkëmbjes

1. Banka e Shqipërisë vlerëson zbatueshmërinë e planit të rimëkëmbjes, duke mbajtur parasysh:

a) nëse zbatimi i marrëveshjeve dhe masave të propozuara në planin e rimëkëmbjes, lidhet në mënyrë të arsyeshme me ruajtjen ose rivendosjen e qëndrueshmërisë dhe pozicionit financiar të bankës apo të grupit bankar, duke marrë parasysh masat përgatitore që banka ka marrë ose ka planifikuar të marrë;

b) nëse plani dhe masat e rimëkëmbjes të përfshira në plan, kanë mundësi të zbatohen më shpejt dhe në mënyrë më të efektshme në situata vështirësie financiare, duke shmangur sa më shumë



çdo pasojë të rëndë negative mbi sistemin financiar.

2. Banka e Shqipërisë, gjatë vlerësimit të planit të rimëkëmbjes mbi plotësimin e kriterëve të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, bazohet në elementet e mëposhtme:

a) nivelin e integritetit dhe të përputhshmërisë së planit të rimëkëmbjes me kulturën e përgjithshme të drejtimit dhe me procedurat e brendshme të bankës apo subjekteve të grupit të përfshirë në planin e rimëkëmbjes, si dhe me sistemin e administrimit të rrezikut të tyre;

b) nëse plani i rimëkëmbjes përmban një numër të mjaftueshëm masash të besueshme dhe të zbatueshme të rimëkëmbjes, që do t'i mundësonin bankës apo grupit bankar të përballonte në mënyrë më të shpejtë dhe më të efektshme skenarët e ndryshëm të përkeqësimit të gjendjes financiare.

c) nëse masat e rimëkëmbjes të përfshira në plan, parashikojnë hapat që duhen ndjekur për t'iu përgjigjur në mënyrë të efektshme, skenarëve të situatave të vështirësive makroekonomike dhe financiare, siç parashikohet në këtë rregullore;

d) nëse afati kohor i zbatimit të masave të rimëkëmbjes është i vërtetë (realist) dhe është marrë në konsideratë gjatë hartimit të procedurave që do të siguronin zbatimin e masave të rimëkëmbjes;

e) nivelin e parapërgatitjes së bankës apo të grupit bankar, i cili do të përcaktohet në veçanti nëpërmjet vlerësimit nëse masat e nevojshme parapërgatitore janë identifikuar në mënyrën e duhur dhe kur ka qenë e nevojshme, këto masa janë zbatuar apo janë hartuar plane për zbatimin e tyre;

f) mjaftueshmërinë e skenarëve për përkeqësimin e gjendjes makroekonomike dhe financiare, kundrejt të cilëve është testuar plani i rimëkëmbjes, duke mbajtur parasysh parimin e proporcionalitetit për bankat me rëndësi josistemike;

g) mjaftueshmërinë e proceseve të testimit të planit të rimëkëmbjes kundrejt skenarëve të parashikuar në shkronjën “f”, si dhe shkallën në të cilën janë verifikuar nga ky testim, analizat e masave të rimëkëmbjes dhe të treguesve për çdo skenar;

h) nëse supozimet dhe vlerësimet e përfshira në planin e rimëkëmbjes, si dhe çdo masë rimëkëmbjeje, janë të vërteta (realiste) dhe të zbatueshme.

3. Për qëllime të vlerësimit të zbatueshmërisë së çdo mase rimëkëmbjeje, sipas kërkesave të parashikuara në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni, Banka e Shqipërisë merr parasysh:

a) nivelin në të cilin zbatimi i masës është nën kontrollin e bankës apo të grupit bankar dhe nivelin në të cilin mund të mbështetet në veprimet e palëve të treta;

b) nëse plani i rimëkëmbjes përfshin një tërësi masash të rimëkëmbjes, si dhe treguesit, kushtet dhe procedurat e përshtatshme që do të siguronin zbatimin në kohën e duhur të këtyre masave;

c) nivelin që plani i rimëkëmbjes parashikon edhe ndikimin që do të kishte zbatimi i masës së propozuar të rimëkëmbjes, te banka apo grupi bankar;

d) nëse plani i rimëkëmbjes dhe në veçanti masat e rimëkëmbjes, do të mund të ruanin qëndrueshmërinë e bankës apo të grupit bankar dhe të rivendosnin pozicionin e saj/tij financiar;

e) në rastet kur është e zbatueshme, mënyrën me të cilën banka apo grupi bankar ose konkurrentët e saj me karakteristika të ngjashme, kanë administruar ngjarje të mëparshme të vështirësive financiare me karakteristika të ngjashme me ato të skenarit të parashikuar, duke zbatuar masat e rimëkëmbjes përkatëse, në veçanti në drejtim të zbatimit në kohën e duhur të masave të rimëkëmbjes dhe, në rastin e një plani rimëkëmbjeje të një grupi bankar, në drejtim të koordinimit të masave të rimëkëmbjes brenda grupit.

4. Banka e Shqipërisë, gjatë vlerësimit të planit të rimëkëmbjes mbi plotësimin e kriterëve të parashikuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, bazohet në elementet e mëposhtme:

a) nëse plani i rimëkëmbjes dhe masat individuale të rimëkëmbjes mund të zbatohen në mënyrë të efektshme dhe në kohën e duhur, edhe në situata të përkeqësimit të gjendjes makroekonomike dhe financiare;

b) nëse plani i rimëkëmbjes dhe masat e veçanta të rimëkëmbjes mund të zbatohen në mënyrë të tillë që të arrijnë objektivat e tyre, pa shkaktuar pasoja të rënda negative në sistemin financiar;

c) nëse tërësia e masave të rimëkëmbjes e redukton rrezikun që pengon zbatimin e këtyre masave ose nëse vërehen pasoja të rënda sistemike për shkak të veprimeve të rimëkëmbjes të bankave



të tjera apo të grupeve të tjerë bankarë, që ndërmerren në të njëjtën kohë;

d) nivelin në të cilin masat e rimëkëmbjes mund të bien ndesh me masat e rimëkëmbjes të bankave apo grupeve bankare që mund të ndeshin vështirësi të ngjashme, në qoftë se masat do të zbatohen në të njëjtën kohë;

e) nivelin në të cilin zbatimi i masave të rimëkëmbjes nga disa banka apo grupe bankare në mënyrë të njëkohshme, mund të ndikojë negativisht tek zbatueshmëria e masave të rimëkëmbjes.

Neni 29

Kërkesa të veçanta për planet e rimëkëmbjes së grupit bankar

1. Banka e Shqipërisë, gjatë vlerësimit të zbatueshmërisë së planit të rimëkëmbjes të grupit bankar, bazohet në elementet e mëposhtme:

a) nivelin në të cilin plani i rimëkëmbjes së një grupi bankar, mund të sigurojë stabilizimin e grupit bankar në tërësi dhe të çdo subjekti të grupit, në veçanti, duke mbajtur parasysh:

i) disponueshmërinë e masave të rimëkëmbjes në nivel grupi, për rivendosjen e pozicionit financiar të një subjekti të grupit, pa cenuar pozicionin financiar të grupit;

ii) nëse, pas zbatimit të një mase të veçantë rimëkëmbjeje, grupi bankar në tërësi dhe çdo subjekt i grupit që synonte të vazhdonte veprimtarinë, sipas kësaj mase të rimëkëmbjes, do të kishte ende një model biznesi të qëndrueshëm;

iii) nivelin në të cilin masat e përfshira në planin e rimëkëmbjes së grupit, sigurojnë një bashkërendim dhe përputhshmëri të masave të parashikuara nga banka mëmë, subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar, si dhe të masave të parashikuara nga çdo subjekt individual i grupit. Banka e Shqipërisë vlerëson, në veçanti, nivelin në të cilin proceset e drejtimit të përgjithshëm të

përfshira në planin e rimëkëmbjes së grupit, marrin në konsideratë edhe strukturën e drejtimit të subjekteve individuale të grupit, si dhe kufizimet e mundshme ligjore përkatëse;

b) në rastet kur janë identifikuar pengesa për zbatimin e masave të rimëkëmbjes brenda grupit bankar, nivelin në të cilin plani i rimëkëmbjes së grupit parashikon zgjidhje për t'i kapërcyer këto pengesa dhe, në rast se pengesat nuk mund të kapërcehen, nivelin në të cilin mund të arrihen të njëjtët objektiva, nëpërmjet zbatimit të masave alternative të rimëkëmbjes;

c) në rastet kur janë identifikuar pengesa të rëndësishme praktike apo ligjore për transferimin e menjëhershëm të fondeve ose për shlyerjen e detyrimeve apo të aktiveve brenda grupit bankar, nivelin në të cilin plani i rimëkëmbjes së grupit, parashikon zgjidhje për t'i kapërcyer këto pengesa dhe në rast se pengesat nuk mund të kapërcehen, nivelin në të cilin mund të arrihen të njëjtët objektiva, nëpërmjet zbatimit të masave alternative të rimëkëmbjes.

KREU IV

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 30

Sanksionet

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton dispozitat e parashikuara në kreun XI, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.

Neni 31

Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko



ANEKSI NR. 1
KATEGORITË E TREGUESVE DHE LISTA MINIMALE E TREGUESVE TË PLANIT
TË RIMËKËMBJES

KATEGORITË E TREGUESVE DHE LISTA MINIMALE E TREGUESVE TË PLANIT TË RIMËKËMBJES (përdorimi i treguesve të tregut dhe makroekonomikë, është subjekt i mundësisë që një bankë të argumentojë nëse një tregues nuk është i përshtatshëm për të, por në të tilla raste, treguesi duhet të zëvendësohet me një tregues tjetër që është më i përshtatshëm për atë bankë)
1. Treguesit e kapitalit
Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit
2. Treguesit e likuiditetit
Treguesi i likuiditetit në total
Treguesi i likuiditetit në lekë
Treguesi i likuiditetit në valutë
Tërheqja ditore e depozitave me afat
3. Treguesit e përfitueshmërisë
Kthimi nga aktivet (ROA)
Kthimi nga kapitali (ROE)
Humbje të konsiderueshme operacionale
Humbje të konsiderueshme nga rreziku i kredisë
4. Treguesit e cilësisë së aktiveve
Norma e rritjes së kredive me probleme bruto
Raporti i Fondeve rezervë/totalit të kredive me probleme
5. Treguesit e tregut dhe makroekonomikë
Vlerësime me perspektivë negative ose vlerësime të përkeqësuar të bankës
Rritja e kostos së borxhit afatgjatë të bankës
Luhatjet e PBB-së
<i>Credit Default Swap</i> (CDS) e qeverisë

ANEKSI NR. 2
LISTA ILUSTRUESE E TREGUESVE SHITESË TË PLANIT TË RIMËKËMBJES

Treguesit shitesë të planit të rimëkëmbjes (listë joshteruese e parashikuar vetëm për qëllime ilustruese)
1. Treguesit e kapitalit
a) Fitimi i pashpërndarë dhe rezervat/totali i kapitalit
b) Përkeqësim i gjendjes financiare të kundërpartive të rëndësishme
2. Treguesit e likuiditetit
a) Përqendrimi i likuiditetit dhe burimeve të financimit
Kostoja e financimit të përgjithshëm (financimi me pakicë dhe në tregun ndërbankar)
c) Maturiteti mesatar i financimit në tregun ndërbankar
d) Mospërputhja e maturimit kontraktual
e) Aktivet e paangazhuara (<i>unencumbered</i>) të disponueshme
3. Treguesit e përfitueshmërisë
a) Raporti shpenzime të veprimtarisë/të ardhura të veprimtarisë
b) Marzhi neto i interesave
4. Treguesit e cilësisë së aktiveve
a) Kreditë me probleme neto/kapital rregullator



b) (Kreditë me probleme bruto + zëra jashtë bilancit me probleme ¹)/totali i kreditë (bruto)
c) Norma e rritjes së zhvlerësimit të aktiveve financiare
d) Kreditë me probleme sipas përqendrimit gjeografik ose sektorial
e) Ekspozimet e ristrukturuara/Totali i kreditë (bruto)
5. Treguesit e tregut dhe makroekonomikë
a) Raporti midis çmimit dhe vlerës kontabël
b) Kërcënime ose dëme reputacionale për bankën
c) Vlerësim i përqësuar për qeverinë ose vlerësim i njëjtë me perspektivë negative
d) Norma e papunësisë
Norma e inflacionit
Norma e marrëveshjeve të riblerjes (REPO)

Aneksi nr. 3 – Formularët raportues për informacionin cilësor të planit të rimëkëmbjes

Plani i rimëkëmbjes - Viti _____

Emri i bankës

Data e referencës

Data e paraqitjes së tabelës

Personi përgjegjës për plotësimin

Formulari nr. 1. Të dhënat kryesore (listë joshteruese)

Emërtimi	Njësia matëse	Vlera
Totali i Aktivit	Në mln lekë	
Kredi dhe paradhënie për klientët (bruto)	Në mln lekë	
Kredi me probleme bruto	Në mln lekë	
Fonde rezervë për kredite me probleme	Në mln lekë	
Kredi me probleme neto	Në mln lekë	
Fonde rezervë statistikore	Në mln lekë	
Raporti i mbulimit me provigjione të kredive me probleme	Në %	
Aktive likuide në total	Në mln lekë	
Aktive likuide në lekë	Në mln lekë	
Aktive likuide në valutë	Në mln lekë	
Treguesi i likuiditetit në total	Në %	
Treguesi i likuiditetit në valutë	Në %	
Treguesi i likuiditetit në lekë	Në %	
Depozitat dhe llogaritë e klientëve	Në mln lekë	
Depozita të siguruara	Në mln lekë	
Kapitali bazë i nivelit të parë	Në mln lekë	
Kapitali rregullator	Në mln lekë	
Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë	Në %	
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	Në %	
Fitimi neto	Në mln lekë	
ROA	Në %	
ROE	Në %	
Raporti shpenzime të veprimtarisë/Të ardhura të veprimtarisë	Në %	
Numri i punonjësve	Njësi	
Numri i degëve	Njësi	
Numri i ATM-ve	Njësi	

¹ Zërat jashtë bilancit që lidhen me kredimarrës me probleme.



Formulari nr. 2. Vlerësimi i veprimtarive kryesore (linjave kryesore) të biznesit

NR.	Veprimtaritë e biznesit (linjat e biznesit)	Kërkesa për kapital		Kontributi në të ardhura		Aktivet/pasivet				Rëndësia strategjike	Veprimtari kryesore?
		Mln Lekë	% e kapitalit	Mln Lekë	% e të ardhurave totale	Aktivet (mln lekë)	% ndaj aktiveve totale	Pasivet (mln lekë)	% ndaj pasiveve totale		
1											
2											
3											
.....											

Formulari nr. 3. Subjekte të rëndësishme të grupit dhe degë të rëndësishme të bankës

NR.	Emri i subjektit	Struktura ligjore	Aksioneri i drejtpërdrejtë	Banka mbizotëruese ose institucioni që kryen konsolidimin	Kapitali	Të drejtat e votës	Kontributi në të ardhurat e grupit ose të bankës	Pesha ndaj të ardhurave totale	Veprimtari kryesore për grupin ose bankën	Kryen në mënyrë të përqendruar funksione bazë	Mbart (zbut) rreziqe kryesore për grupin ose bankën	Shitja/Likuidimi i subjektit ekspozon grupin/bankën ndaj rreziqeve të rëndësishme	Vendi ku ushtron veprimtarinë	Është i rëndësishëm për stabilitetin financiar?	Subjekt i rëndësishëm i grupit ose degë e rëndësishme e bankës?
							Mln lekë	%	Lista e veprimtarive	Lista e funksioneve	Lista e rreziqeve	Lista e rreziqeve			
							070	080	090	100	110	120			
1															
2															
3															
4															
....															



Formulari nr. 4. Ndërlidhjet e jashtme

4/1 10 Kundërpasitë kryesore (Aktivet)

Nr.	Subjekti	10 Kundërpasitë kryesore	Vendi ku ushtron veprimtarinë	Monedha	Ekspozimi total (mln lekë)	Zbutja e rrezikut të kredisë	Rregullimi i vlerës dhe fondet rezervë	Ekspozimi neto	Ekspozimi total / Aktivitet totale të grupit (%)
	010	020	030	040	050	060	070	080	090
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									
10									

4/2 10 Kundërpasitë kryesore (Detyrimet)

Nr.	Subjekti	10 Kundërpasitë kryesore	Vendi ku ushtron veprimtarinë	Monedha	Financimi total (mln lekë)	Lloji i financimit	Detyrimi / Detyrimet totale të grupit (%)
	010	020	030	040	050	060	070
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							



4/3

Shërbimet kryesore që palët e treta i ofrojnë bankës ose grupit

Nr.	Subjekti	Furnizuesi	Shërbimet kryesore të ofruara	Kosto e shërbimit (mln lekë)	Vendi ku furnizuesi ushtron veprimtarinë
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					



Formulari nr. 5. Funksionet kritike

[illegible]



ANEKSI NR. 4

FORMULARËT RAPORTUES PËR INFORMACIONIN SASIOR TË PLANIT TË RIMËKËMBJES

Formulari nr. 1. Kuadri i treguesve të planit të rimëkëmbjes

Kuadri i treguesve të planit të rimëkëmbjes				Të dhënat në përqindje, vetëm si numër p.sh. 10% duhet të shënohet si "10" - dhe jo "10%" ose "0,1"					
Nr.	Emri i treguesit (emri i përdorur në planin e rimëkëmbjes)	Kategoria e treguesit	Njësia matëse	Referenca rregullatore	Formula e llogaritjes	Vlera në datën e referencës	Niveli i paralajmërimit të hershëm	Niveli i treguesit për aktivizimin e planit	Komente (nëse nevojiten)
Lista minimale e treguesve të planit të rimëkëmbjes									
1	Raporti i kapitalit bazë të nivelit të parë	Tregues të kapitalit	Përqindje	Rregullorja për kapitalin rregullator					
2	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	Tregues të kapitalit	Përqindje	Rregullorja për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit					
3	Treguesi i likuiditetit në total	Tregues të likuiditetit	Përqindje	Rregullorja për administrimin e rrezikut të likuiditetit					
4	Treguesi i likuiditetit në lekë	Tregues të likuiditetit	Përqindje	Rregullorja për administrimin e rrezikut të likuiditetit					
5	Treguesi i likuiditetit në valutë	Tregues të likuiditetit	Përqindje	Rregullorja për administrimin e rrezikut të likuiditetit					
6	Tërheqja ditore e depozitave me afat	Tregues të likuiditetit	Përqindje						
7	Kthimi nga aktivet (ROA)	Tregues të përfitueshmërisë	Përqindje						
8	Kthimi nga kapitali (ROE)	Tregues të përfitueshmërisë	Përqindje						
9	Humbje të konsiderueshme operacionale	Tregues të përfitueshmërisë	Në mln lekë	Rregullorja për administrimin e rrezikut operacional					
10	Humbje të konsiderueshme nga rreziku i kredisë	Tregues të përfitueshmërisë	Në mln lekë	Rregullorja për administrimin e rrezikut të kredisë					
11	Norma e rritjes së kredive me probleme bruto	Tregues të cilësisë së aktiveve	Përqindje						
12	Raporti i fondeve rezervë / Totali i kredive me probleme	Tregues të cilësisë së aktiveve	Përqindje						
13	Vlerësime me perspektivë negative ose vlerësime të përkeqësuar të bankës	Tregues të tregut dhe makroekonomikë	Po/Jo						
14	Rritja e kostos së borxhit afatgjatë të bankës	Tregues të tregut dhe makroekonomikë	Përqindje						
15	Luhatjet e PBB-së	Tregues të tregut dhe makroekonomikë	Përqindje						
16	Credit Default Swap (CDS) e qeverisë	Tregues të tregut dhe makroekonomikë	Pikë bazë						
Treguesit e tjerë (shtesë)									
20	Për t'u përshtatur me treguesit e Aneksit nr. 2 të rregullores								
21									
22									
23									
24									
25									
26									
27									
28									

Page | 11946



Formulari nr. 2b. Lista e masave të rimëkëmbjes: aftësia e agreguar e rimëkëmbjes

Lista e masave të rimëkëmbjes: aftësia e agreguar e rimëkëmbjes																					Treguesit shtesë					
Supozime: situata aktuale e tregut (mundësi e krizës) Në litem përdorni numra pozitivë për rritje; numra negativë për rënie																										
Nr.	Masa e rimëkëmbjes (emri i përdorur në planin e rimëkëmbjes)	Kategoria	Zbatueshmëria e masës	Koha e materializimit të efektit	Ndikimi mbi raportin e kapitalit bazë të nivelit të parë	Ndikimi mbi kapitalin bazë të nivelit të parë	Ndikimi mbi raportin e mjetueshmërisë së kapitalit	Ndikimi mbi kapitalin rregulator	Ndikimi mbi ekspozimet e ponderuara me rrezikun	Ndikimi mbi treguesin total të likuiditetit	Ndikimi mbi treguesin e likuiditetit në lekë	Ndikimi mbi treguesin e likuiditetit në valutë	Ndikimi mbi lëshimin e detyrës të depozitave me afat	Ndikimi mbi kthimin nga aktivet	Ndikimi mbi kthimin nga kapitali	Ndikimi mbi humbjet operacionale	Ndikimi mbi humbjet nga rreziku i kreditit	Ndikimi mbi numrin e rritjes së kredive me probleme bruto	Ndikimi mbi raportin e fondëve rezervohetale të kredive me probleme	Ndikimi mbi vlerësimet (ratings) të bankës	Ndikimi mbi kostot e borxhit afatgjatë të bankës	Komente dhe supozime	Për t'u përshtatur me treguesit e Aneksit nr. 2 të rregullores	0	0	0
Nr.	Emri	Emri i kategorisë	Zbatueshmëria e masës	Muaj	Përqindje	Mn lekë	Përqindje	Mn lekë	Mn lekë	Përqindje	Përqindje	Përqindje	Përqindje	Përqindje	Përqindje	Përqindje	Përqindje	Përqindje	Përqindje	Pa/Jo	Përqindje		0	0	0	
1																										
2																										
3																										
4																										
5																										
6																										
7																										
8																										
9																										
10																										
11																										
12																										
13																										
14																										
15																										
16																										
17																										
18																										
19																										
20																										
21																										
22																										
23																										
24																										
25																										
26																										
27																										
28																										
29																										
30																										
31																										
32																										
33																										
34																										
35																										
36																										
37																										
38																										
39																										
40																										
41																										
42																										
43																										
44																										
45																										
46																										
47																										
48																										
49																										
50																										

Emri i skenarit (siç përdoret në planin e rimëkëmbjes)	Tekst	
Lloji i skenarit	Tekst	
Shpejtësia e skenarit	Tekst	
Përshkrim i shkurtër i skenarit	Tekst	

Ndikimi i skenarit mbi treguesit kryesorë financiarë	Njësitë	Vlera në datën e referencës së planit	3 muaj	1 vit
Ndikimi mbi raportin e kapitalit bazë të nivelit të parë	Përqindje			
Ndikimi mbi kapitalin bazë të nivelit të parë	Mln lekë			
Ndikimi mbi raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit	Përqindje			
Ndikimi mbi kapitalin rregullator	Mln lekë			
Ndikimi mbi ekspozimet e ponderuara me rrezikun	Mln lekë			
Ndikimi mbi treguesin e likuiditetit total	Përqindje			
Ndikimi mbi treguesin e likuiditetit në lekë	Përqindje			
Ndikimi mbi treguesin e likuiditetit në valutë	Përqindje			
Ndikimi mbi tërheqjen ditore të depozitave me afat	Përqindje			
Ndikimi mbi kthimin nga aktivet	Përqindje			
Ndikimi mbi kthimin nga kapitali	Përqindje			
Ndikimi mbi humbjet e konsiderueshme operacionale	Në mln lekë			
Ndikimi mbi humbjet e konsiderueshme nga rreziku i kredisë	Në mln lekë			
Ndikimi mbi normën e rritjes së kredive me probleme bruto	Përqindje			
Ndikimi mbi raportin e fondeve rezervë/totalit të kredive me probleme	Përqindje			
Ndikimi mbi vlerësimet (ratings) të bankës	Po/Jo			
Ndikimi mbi koston e borxhit afatgjatë	Përqindje			

[illegible][illegible][illegible]

***Çdo skenar duhet të ndërtohet për ta çuar bankën pranë një situatë paafësie paguese, ku të paktën një nga kufijtë rregullatorë duhet të thyhet. Ju lutemi shënoni numrin e muajve derisa kjo thyerje të ndodhë (nëse nuk do të zbatohen masat). Në rast se nuk thyhet asnjë kufi rregullator, geliza duhet të lihet bosh.*



Shënime shpjeguese për plotësimin e formularëve të aneksit nr. 3, për raportimin e informacionit cilësor të planit të rimëkëmbjes

Formulari nr. 3. Subjekte të rëndësishme të grupit ose degë të rëndësishme të bankës

Shënime shpjeguese sipas kolonave specifike:

Kolonat	Referenca ligjore dhe udhëzimet
010-020	Subjekti i grupit
010	Emri i subjektit
020	Struktura ligjore Lloji i licencës (për shembull: bankë, degë e bankës, subjekt financiar jobankë etj.)
030	Aksionari i drejtpërdrejtë Emri i subjektit që zotëron një pjesëmarrje dhe kontroll të drejtpërdrejtë në subjektin e grupit të listuar në kolonën 010.
040	Banka mbizotëruese ose institucioni që kryen konsolidimin Emri i bankës mbizotëruese të grupit bankar/financiar sipas përcaktimeve në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” ose emri i institucionit që kryen konsolidimin e subjektit të listuar në kolonën 010, në rastin kur banka është pjesë e grupit bankar/financiar të huaj.
050	Kapitali (%) Përqindja e kapitalit e mbajtur nga subjekti i grupit i listuar në kolonën 030, në subjektin e grupit të listuar në kolonën 010.
060	Të drejtat e votës (%) Përqindja e të drejtave të votës të zotëruara nga subjekti i grupit i listuar në kolonën 030, në subjektin e grupit të listuar në kolonën 010.
070	Kontributi në të ardhurat e grupit/bankës Kontributi (i shprehur në milionë lekë) i subjektit të listuar në kolonën 010, në të ardhurat e grupit ose të bankës.
080	Pesha ndaj të ardhurave totale (%) Kontributi (i shprehur në përqindje) i subjektit të listuar në kolonën 010 në të ardhurat e grupit ose të bankës.
090	Kryen veprimtari kryesore për grupin/bankën Listoni veprimtaritë kryesore të kryera nga subjekti për grupin/bankën.
100	Kryen në mënyrë të përqendruar funksione bazë Listoni funksionet bazë të kryera nga subjekti në mënyrë të përqendruar.
110	Mbart/zbut rreziqet kryesore për grupin ose bankën Listoni rreziqet që mbarten ose zbuten nga subjekti.
120	Shitja/likuidimi i subjektit ekspozon grupin/bankën ndaj rreziqeve të rëndësishme Listoni rreziqet ndaj të cilave është ekspozuar grupi/banka.
130	Vendi ku ushtron veprimtarinë Identifikimi i vendeve ku ushtron veprimtarinë subjekti i listuar në kolonën 010.
140	Rëndësia për stabilitetin financiar Tregoni me “Po” ose “Jo” nëse subjekti është i rëndësishëm për stabilitetin financiar të vendit.
150	Subjekt i rëndësishëm i grupit/degë e rëndësishme e bankës Tregoni me “Po” ose “Jo”, nëse subjekti i listuar në kolonën 010, është subjekt i rëndësishëm i grupit apo degë e rëndësishme e bankës.

**Formulari nr. 4. Ndërlidhjet e jashtme****4/1 Ndërlidhjet e jashtme (Aktivet)**

Në këtë tabelë, në përgjithësi, duhet të ketë një rresht për secilën nga 10 kundërpartitë kryesore. Megjithatë, kur ekspozimi total ndaj një kundërpartie përbëhet nga ekspozime në disa monedha, kjo duhet të ndahet në rreshta të veçantë, ku shuma e ekspozimeve në rreshtat e veçantë, i shtohet ekspozimit total ndaj kundërpartisë.

Shënime shpjeguese sipas kolonave specifike:

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
010	Subjekti
020	10 Kundërpartitë kryesore Kufiri për të përcaktuar nëse një kundërparti konsiderohet ose jo kryesore, duhet të përcaktohet nga vetë banka. Kundërpartitë duhet të raportohen për grupet e personave të lidhur dhe në rast se klienti nuk i përket një grupi personash të lidhur, do të raportohet në nivel individual. Siç u sqarua edhe më sipër, një kundërparti mund të renditet disa herë në këtë formular, nëse ekspozimi total është i përbërë nga ekspozime në monedha të ndryshme.
030	Vendi ku ushtron veprimtarinë Tregoni vendin ku ushtron veprimtarinë kundërpartia e listuar në kolonën 020.
040	Monedha Kjo duhet të jetë monedha origjinale e ekspozimit.
050	Ekspozimi total (në mln lekë) Shumat e ekspozimit duhet të raportohen në milionë lekë. Kur monedha origjinale nuk është lek, vlera duhet të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të datës së raportimit.
060	Zbutja e rrezikut të kredisë Zbutja e rrezikut të kredisë (CRM), siç përcaktohet në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, raportohet në milionë lekë. Për qëllime të këtij formulari, do të përdoret teknika e zbutjes së rrezikut të kredisë, e përdorur/njohur edhe për qëllime të raportimit të mjaftueshmërisë së kapitalit.
070	Rregullimi i vlerës dhe fondet rezervë Rregullimi i vlerës dhe fondet rezervë, siç përcaktohen në nenin 9, të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, raportohet në milionë lekë.
080	Ekspozimi neto $080 = 050 - 060 - 070$
090	Ekspozimi total/Aktivet totale të grupit Raporti i ekspozimit total ndaj një kundërpartie, me aktivet totale të grupit bankar ose të bankës.

4/2 Ndërlidhjet e jashtme (detyrimet)

Në këtë tabelë, në përgjithësi, duhet të ketë një rresht për secilën nga 10 kundërpartitë me kryesore. Megjithatë, kur detyrimi total ndaj një ofruesi të fondeve/financimeve përbëhet nga detyrime në disa monedha, kjo duhet të ndahet në rreshta të veçantë, ku shuma e detyrimeve në rreshtat e veçantë, i shtohet detyrimit total ndaj kundërpartisë.

Shënime shpjeguese sipas kolonave specifike:

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
010	Subjekti
020	10 Kundërpartitë kryesore Kufiri për të përcaktuar nëse një kundërparti konsiderohet ose jo kryesore, duhet të përcaktohet nga vetë banka. Siç u sqarua edhe më sipër, një kundërparti mund të renditet disa herë në këtë formular, nëse ekspozimi total është i përbërë nga ekspozime në monedha të ndryshme.
030	Vendi ku ushtron veprimtarinë Tregoni vendin ku ushtron veprimtarinë kundërpartia e listuar në kolonën 020
040-070	Financimi
040	Monedha Kjo duhet të jetë monedha origjinale e detyrimit.
050	Financimi total



Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
	I shprehur në milionë lekë.
060	Lloji i financimit Lloji i financimit, i cili duhet specifikuar (depozitë, obligacion etj.)
070	Detyrimi/Detyrimet totale të grupit

Formulari nr. 5. Funksionet kritike

Funksionet kritike duhet të përcaktohen nga vetë subjekti raportues, në përputhje me modelin individual të biznesit dhe me strukturën organizative, duke marrë parasysh përkufizimin e funksionit kritik të dhënë në Ligjin nr. 133/2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka”.

Si pikënisje, të gjitha funksionet ekonomike ose analitike të kryera nga banka duhet të raportohen dhe secili prej tyre, duhet të vlerësohet për kritikabilitetin (nëse është kritik ose jo). Bankat duhet të hartojnë metodologji të brendshme për përcaktimin e funksioneve ekonomike dhe vlerësimin e kritikabilitetit të tyre.

Banka duhet të marrë parasysh funksionet e mëposhtme ekonomike, gjatë përcaktimit të funksioneve kritike:

Pranimi i depozitave (aty ku është e mundur) mund të ndahet në llogari rrjedhëse dhe llogari kursimi të individëve dhe të bizneseve (duke ndarë mundësisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të) nga shoqëritë tregtare (korporatat)), llogari rrjedhëse/kursimi në monedhë vendase dhe në monedhë të huaj, llogari rrjedhëse/kursimi të klientëve vendas (rezidentë) dhe të huaj (jorezidentë), llogari rrjedhëse/kursimi të institucioneve financiare dhe të sektorit publik (qeverive qendrore apo rajonale ose autoriteteve lokale).

Kredidhënia (aty ku është e mundur) mund të ndahet në kredi ndaj individëve dhe ndaj shoqërive tregtare (korporatave) (duke ndarë mundësisht SME-të nga shoqëritë tregtare), kredi hipotekare dhe lloje të tjera të kredive (sipas ndarjes së vetë bankës), kredi në monedhë vendase dhe në monedhë të huaj, kredi brenda vendit dhe jashtë territorit të vendit ku ushtron veprimtarinë, kredi sindikatë, kredi ndaj institucioneve financiare dhe ndaj sektorit publik (qeverive qendrore apo rajonale ose autoriteteve lokale).

Shërbimet e pagesave, shërbime me *cash*-in, të shlyerjes, klerimit dhe marrjes në kujdestari (aty ku është e mundur) duhet të ndahen në shërbime pagesash për individët dhe bizneset, pagesa

ndërbankare (banka korrespondente), forma të ndryshme pagesash (p.sh. në letër, elektronike), pagesa në monedhën vendase dhe në monedhë të huaj, furnizimi me *cash* (ATM, degë), shlyerja e titujve, shërbimi i klerimit të titujve (mundësisht të ndara midis shërbimeve për klientët e bankës kundrejt shërbimeve si ndërmjetës për bankat e tjera), shërbimet e marrjes në kujdestari etj.

Tregjet e kapitalit (aty ku është e mundur) duhet të ndahen në tregje primare (nënshkrimi dhe emetimi i titujve dhe, më tej, mund të ndahen sipas llojit të produktit, p.sh. tituj borxhi dhe tituj kapitali) dhe tregje sekondare/dytësore (nëse është e mundur, të ndahen sipas titujve: të kapitalit, të kredisë, derivativët), administrimi i aktiveve etj.

Financimi në tregun ndërbankar: (aty ku është e mundur), duhet të ndahen në marrëveshje të riblerjes, huamarrje ndërbankare, huadhënie ndërbankare, huadhënie dhe huamarrje e titujve, huadhënie me marzhe dhe derivativë, veprime me letrat tregtare etj.

Bankat duhet të përpiqen t'i plotësojnë rreshtat dhe të tregojnë në kolonën 420 nëse e konsiderojnë një ndarje të mundshme (në funksione analitike), si një funksion të veçantë në rastin e tyre (nëse jo, N/A duhet të zgjidhet në këtë kolonë dhe në kolonën 430 të sqarojnë se pjesë e cilit funksion është ky rresht). Funksionet ekonomike/analitike që paraqiten në formular, nuk duhet të interpretohen si një listë e detyrueshme e funksioneve, por kanë natyrë ilustruese dhe orientuese për bankën. Bankat duhet të vlerësojnë nivelin e detajimit, sipas rrethanave të tyre specifike dhe të raportojnë vetëm rreshtat që lidhen me to. Kjo mund të sjellë kombinimin e disa funksioneve analitike në një funksion të vetëm ekonomik (p.sh. mund të mos paraqitet ndarja sipas monedhës ose sipas rezidencës, por gjithashtu mund të fshihen SME-të si një funksion analitik, nëse SME-të mbulohen nga shërbimet e kredidhënies/depozitave të segmenteve të tjerë). Nëse banka gjykon se duhet të sigurojë një detajim të mëtejshëm për funksione të veçanta, ajo mund të shtojë rreshta të tjerë në formular, sipas nevojës.



Udhëzime për plotësimin e kolonave specifike:

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
010	Funksionet ekonomike/funksionet analitike Këto funksione përfshijnë, por nuk kufizohen në “funksionet kritike” sipas nenit 4 (18) të Ligjit Nr. 133/2016. Bankat duhet të listojnë të gjitha funksionet ekonomike apo funksionet analitike që kryejnë dhe të përcaktojnë funksionet kritike në kolonën 420.
020	Veprimtaritë kryesore (linjat kryesore të biznesit) Banka liston veprimtaritë kryesore sipas nenit 4(48) të ligjit nr. 133/2016, të cilat i korrespondojnë funksioneve ekonomike/funksioneve analitike të listuara në kolonën 010.
030-040	Subjekti
030	Emri i subjektit
040	Kodi identifikues i subjektit Kodi 20-shifror alfa-numerik i subjektit të identifikuar në kolonën 030. Kodi identifikues i subjektit të grupit, identifikon në mënyrë unike çdo subjekt juridik ose strukturë që është pjesë e një transaksioni financiar, në çdo juridiksion. Në rastet kur “kodi identifikues i subjektit” nuk është i disponueshëm për një subjekt të caktuar, duhet të sigurohet një formë tjetër identifikimi. Vetëm në rastet kur nuk ekziston ndonjë formë tjetër identifikimi, lejohet të thuhet “jo i aplikueshëm (N/A)”.
130-170	Personi me përgjegjësi operacionale për sigurimin e informacionit Personi me pozicionin më të lartë, i cili ka përgjegjësinë operacionale për sigurimin e informacionit.
130	Emri Emri, mbiemri
140	Funksioni
150	Departamenti
160	Numrat e telefonit Numri i telefonit të departamentit dhe numri i telefonit personal të personit, emri i të cilit paraqitet në kolonën 130.
170	Adresat e postës elektronike (e-mail) Adresa e e-mail-it të departamentit dhe adresa personale e e-mail-it të personit, emri i të cilit paraqitet në kolonën 130.

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
200	Pesha në treg (në përqindje) Në këtë kolonë, duhet të raportohet pesha e llogaritur (ose e vlerësuar) e tregut, e shprehur në përqindje. Pesha e tregut duhet të llogaritet duke pjesëtuar vlerën e llogarive/numrin e transaksioneve (sipas funksionit) të bankës raportuese me vlerën e përgjithshme/numrin e transaksioneve në treg (ose në gjithë vendin).
210	Numri i klientëve (në mijë) Në këtë kolonë, duhet të përfshihet numri i përgjithshëm i klientëve për një shërbim të caktuar (p.sh. pranimin e depozitave, kredidhënien, shërbimet e pagesave, tregjet e kapitalit, tregun ndërbankar). Nëse një klient ka më shumë se një llogari ose kryen transaksione të shumëllojshme, klienti duhet të numërohet vetëm një herë.
220	Numri i llogarive (në mijë) Në këtë kolonë, duhet të përfshihet numri i përgjithshëm i llogarive (vetëm për shërbimet e pranimit të depozitave). Numri i llogarive duhet të korrespondojë me vlerën e llogarive dhe numrin e klientëve të raportuar për të njëjtin shërbim.
230	Vlera e llogarive (në milionë lekë) Në këtë kolonë, duhet të përfshihet vlera totale e mbajtur në llogaritë rrjedhëse dhe të kursimit (për shërbimet e pranimit të depozitave) ose totali i tepicës së kredisë (për shërbimet e kredidhënies), siç paraqitet në bilanc dhe duhet të korrespondojë me numrin e klientëve të raportuar për të njëjtin shërbim.
235	Ekspozimet jashtë bilancit (në milionë lekë) Në këtë kolonë, duhet të raportohet ekspozimi total jashtë bilancit (vetëm për shërbimet e kredidhënies), pas aplikimit të rregullimit të vlerës sipas aneksit 2, të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” dhe duhet të korrespondojë me numrin e klientëve të raportuar



	për të njëjtin shërbim.
240	Ekspozimet e ponderuara me rrezikun (në milionë lekë) Kjo kolonë plotësohet vetëm për shërbimet e kredithënies dhe duhet të përfshijë shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun si për vlerën e bilancit të llogarive ashtu dhe në çdo ekspozim jashtë bilancit, që korrespondon me klientët e përfshirë në kolonën e “numrit të klientëve” për këtë shërbim.
250	Numri i transaksioneve (në mijë) Kjo kolonë plotësohet vetëm për shërbimet e pagesave, shërbimet me <i>cash-in</i> (<i>ATM etj.</i>) dhe shërbimet e shlyerjes së titujve dhe tregon numrin mesatar të transaksioneve ditore përgjatë një viti (ose përgjatë një periudhe tjetër nëse mesataret vjetore nuk janë të disponueshme). Për shërbimet me <i>cash-in</i> , kjo kolonë duhet të përfshijë numrin mesatar të tërheqjeve nga ATM-të dhe tërheqjeve në sportel, ndërsa për shërbimet e shlyerjes së titujve, kjo kolonë duhet të përfshijë numrin e transaksioneve të transferimit të titujve të shlyera për llogari të klientëve.
260	Vlera e transaksioneve (në milionë lekë) Kjo kolonë plotësohet vetëm për shërbimet e pagesave, shërbimet me <i>cash-in</i> dhe shërbimet e shlyerjes së titujve dhe tregon vlerën mesatare të transaksioneve ditore përgjatë një viti (ose përgjatë një periudhe tjetër nëse mesataret vjetore nuk janë të disponueshme). Për shërbimet me <i>cash-in</i> dhe shërbimet e shlyerjes së titujve, vlerat duhet të korrespondojnë me llojin e transaksioneve të përfshira në “numrin e transaksioneve”.
270	Numri i ATM-ve Kjo kolonë plotësohet vetëm për shërbimet me <i>cash-in</i> dhe duhet të tregojë numrin e terminaleve të ATM-ve (të zotëruara nga banka) në Shqipëri, pavarësisht vendndodhjes së tyre, për shembull nëse janë brenda degëve të bankës apo diku tjetër.
280	Aktive nën administrim/kujdestari (në milionë lekë) Kjo kolonë përfshin vlerën totale të aktiveve nën administrim (për shërbimet e administrimit të aktiveve) ose aktivet në kujdestari (shërbimet e marrjes në kujdestari) që korrespondojnë me “numrin e klientëve” të raportuar për shërbimin përkatës.
290	Të tjera Kjo kolonë përfshin çdo informacion të përshtatshëm ose të rëndësishëm për shërbimet individuale që nuk janë raportuar diku tjetër, së bashku me komentet përkatëse.

Për çdo funksion të identifikuar, bankat duhet të ofrojnë një sërë të dhënash sasiore për të mbështetur vlerësimin nëse funksioni është ose jo kritik. Lloji i të dhënave të kërkuara ndryshon në varësi të funksionit që po shqyrtohet. Formulari përmban kolona për lloje të ndryshme të të dhënave të aplikueshme sipas funksioneve – për këtë arsye, jo të gjitha kolonat do të duhet të plotësohen për secilin funksion. Nëse një e dhënë nuk është e aplikueshme për një funksion, kjo qelizë duhet të lihet bosh.

Udhëzime për plotësimin e kolonave me të dhëna sasiore:

Për çdo funksion të identifikuar, bankat duhet të sigurojnë (kryesisht) informacion cilësor në lidhje me zëvendësueshmërinë e një funksioni të caktuar, nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut. Kur ky informacion nuk është i disponueshëm për një funksion të caktuar, fusha përkatëse duhet të lihet bosh dhe të jepet një koment për këtë çështje në kolonën 340.

Udhëzime për plotësimin e kolonave që lidhen me analizën e zëvendësueshmërisë:

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
300	Përqendrimi i tregut Përqendrimi i tregut matet me numrin e konkurrentëve që aktualisht kryejnë funksione të ngjashme ekonomike dhe/ose ofrojnë shërbime të ngjashme me kushte të njëjta, që potencialisht mund të marrin (pjesërisht ose plotësisht) klientët dhe/ose veprimtaritë e bankës raportuese, brenda një intervali kohor të arsyeshëm. Informacioni duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme: L: <5 ML: 5-10 MU: 10-20 U: ≥ 20
310	Koha e zëvendësimit Koha e zëvendësimit duhet të llogaritet si koha e nevojshme për përthithjen nga tregu të funksionit ekonomik të ofruar nga banka raportuese, në një situatë krize. Koha duhet të përfshijë si kohën që u nevojitet konkurrentëve për të përmbushur hapat ligjorë dhe teknikë për të marrë/ofruar funksionin, ashtu edhe kohën që nevojitet për përdoruesit e shërbimit për



Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
	t'u zhvendosur në një ofrues tjetër shërbimi. Informacioni duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme: Depozitat, kredidhënia, tregjet e kapitalit Pagesat, shërbime me cash-in, shlyerje, shërbimi i marrjes në kujdestari Tregu ndërbankar L: > 6 muaj L: > 1 javë L: > 1 muaj ML: 1-6 muaj ML: 2 ditë – 1 javë ML: 1 javë – 1 muaj MU: 1 javë deri 1 muaj MU: 1 -2 ditë MU: 1 ditë – 1 javë U: < 1 javë U: < 1 ditë U: < 1 ditë
320	Pengesat ligjore të zëvendësimit Këtu vlerësohet rëndësia e pengesave ligjore që hasin konkurrentët për të ofruar shërbimin, p.sh. licenca, kapitali minimal i kërkuar etj. Informacioni duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme: L: pengesa kritike (të vështira për t'u kapërcyer) ML: pengesa thelbësore (por të kapërcyeshme) MU: ka disa pengesa U: nuk ka pengesa të mëdha
330	Kërkesat operationale të zëvendësimit (hyrja ose zgjerimi në treg) Këtu vlerësohet rëndësia e kërkesave operationale, teknike dhe infrastrukturore për konkurrentët që do të ofrojnë shërbimin. Këtu përfshihen kërkesat për të investuar në infrastrukturë (të re ose shtesë) ose ndryshime organizative të konkurrentëve. Kjo kolonë duhet të përfshijë edhe një vlerësim të aftësisë së tregut për të përthithur (absorbuar) një veprimtari të caktuar, në terma, p.sh. të kërkesave për kapital. Informacioni duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme: L: kërkesa kritike (të vështira për t'u përmbushur) ML: kërkesa thelbësore (por të realizueshme/që mund të përmbushen) MU: ka disa kërkesa U: nuk ka kërkesa të mëdha
340	Komente Në këtë kolonë, banka duhet të përfshijë komente në lidhje me pengesat specifike ligjore dhe/ose operationale, si dhe arsyet për një kohë më të gjatë të zëvendësimit, në rastet kur ML ose L janë zgjedhur në secilën nga listat e alternativave për elementet e mësipërme.

Udhëzime për plotësimin e kolonave mbi vlerësimin e kritikalishtit të një funksioni:

Kolona	Referenca ligjore dhe udhëzimet
400	Ndikimi (impakti) Në këtë kolonë, duhet të paraqitet një vlerësim i përgjithshëm mbi ndikimin e pritshëm të ndërprerjes së secilit funksion, duke marrë parasysh treguesit e ndryshëm të vlerësuar më parë (p.sh. madhësia, pjesa e tregut). Përfundimi mbi vlerësimin e përgjithshëm të ndikimit duhet të shprehet në mënyrë cilësore dhe duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme. L: ndërprerja ka një ndikim të madh në tregun kombëtar ML: ndikimi është i rëndësishëm MU: ndikimi është material, por i kufizuar U: ndikimi është i ulët Për aktivitetet e kredidhënies, vlerësimi i ndikimit duhet të paraqesë pikëpamjen e bankës mbi ndikimin e ndërprerjes së ofrimit të kredive për individët, korporatat dhe qeverinë, mbi këto grupe interesi dhe mbi ekonominë e vendit në tërësi.
410	Zëvendësueshmëria Në këtë kolonë, duhet të paraqitet një vlerësim i përgjithshëm i shkallës së pritshme të zëvendësueshmërisë për secilin funksion, duke marrë parasysh dimensionet e ndryshme të vlerësuar më parë (pjesa e tregut, përqendrimi i tregut, koha e zëvendësimit, pengesat ligjore dhe kërkesat operationale për hyrjen ose zgjerimin në treg). Përfundimi mbi vlerësimin e përgjithshëm të zëvendësueshmërisë duhet të shprehet në mënyrë cilësore dhe duhet të raportohet duke përzgjedhur një nga alternativat e mëposhtme. L: funksioni nuk mund të zëvendësohet lehtë ose shpejt ML: funksioni zëvendësohet me vështirësi MU: funksioni mund të zëvendësohet me vështirësi të pakta



	U: funksioni mund të ofrohet lehtësisht nga një bankë tjetër në kushte të krahasueshme dhe brenda një afati kohor të arsyeshëm
420	Funksion kritik Në këtë kolonë, tregoni nëse funksioni është kritik duke përzgjedhur “Po” ose “Jo” nga lista e alternativave. Sa më i madh të jetë ndikimi, aq më shumë gjasa ka, që funksioni të jetë kritik. Në mënyrë të ngjashme, sa më e vështirë është të gjendet një ofrues tjetër i krahasueshëm, aq më shumë pritet që funksioni të jetë kritik.
430	Komente Në këtë kolonë, banka mund të paraqesë komente shitesë që ndikojnë në vlerësimin e saj, nëse funksioni është kritik ose jo. Këto komente janë të rëndësishme, veçanërisht nëse banka e konsideron një funksion si jo kritik, pavarësisht se ky i fundit ka një peshë të lartë të tregut ose, e kundërta, nëse e konsideron një funksion si kritik, pavarësisht se e ka vlerësuar me një ndikim relativisht të ulët.

Shënime shpjeguese për plotësimin e formularëve të aneksit nr. 4, për raportimin e informacionit sasior të planit të rimëkëmbjes

Kodi i ngjyrave
Qelizat në ngjyrë të gjelbër duhet të plotësohen nga banka.
Qelizat në ngjyrë të verdhë plotësohen automatikisht mbi bazën e informacionit të vendosur në qelizat e tjera. Megjithatë, ato duhen rishikuar me kujdes dhe ndryshuar kur është e përshtatshme.
Qelizat në ngjyrë gri nuk duhet të ndryshohen.
Aty ku jepen shembuj të plotësimit, ju lutemi të fshini shembujt kur të plotësoni me të dhënat tuaja.
Formulari 1: Kuadri i treguesve të planit të rimëkëmbjes
Në këtë formular paraqitni një pasqyrë të plotë të të gjithë treguesve dhe kufijve, të cilët aktivizojnë planin e rimëkëmbjes. Për listën e treguesve minimalë, formulari është i plotësuar. Për tregues të cilët nuk përdoren, nuk ka nevojë të jepen vlera. Për tregues shtesë specifikë të bankës, ju lutem të vendoset informacioni në grupimin e dytë "tregues të tjerë".
Formulari 2a: Masat e rimëkëmbjes: secila më vete (stand alone) në datën e sotme
Në këtë formular paraqitni një pasqyrë të plotë të të gjitha masave të rimëkëmbjes që do të ndërmerren potencialisht, kur të aktivizohet plani i rimëkëmbjes. Secila masë e mundshme e rimëkëmbjes duhet të kategorizohet, vlerësohet për zbatueshmërinë dhe të përshkruhet nga ana sasiore për treguesit më të rëndësishëm, të detyrueshëm, të marrë secili më vete (on a stand-alone basis) (d.m.th. nëse përdoret vetëm kjo masë e rimëkëmbjes dhe asnjë tjetër). Ju lutem vlerësoni ndikimin në nivelin e kapitalit, situatën e likuiditetit etj., në kushtet e skenarit bazë (mungesë krize). Me ndihmën e tabelave të tjera, ju do të jeni në gjendje të përshtasni vlerësimet e lartpërmendura për skenarë specifikë krizash. Për masa të pazbatueshme, nuk nevojitet të jepen përshkrim sasior (por, ju lutem përfshijni ato në listë, në mënyrë që të jetë e qartë se ato janë marrë në konsideratë).
Formulari 2b: Masat e rimëkëmbjes: aftësia e agreguar e rimëkëmbjes (në datën e sotme)
Ky formular është një kopje e Formularit 2a, megjithatë, kur ta plotësoni atë, supozoni se të gjitha masat e rimëkëmbjes janë përdorur në të njëjtën kohë. Pra, Formulari 2b duhet të përmbajë vetëm masën më efektive, në kushtet kur dy ose më shumë masa përjashtojnë njëra - tjetrën.
Formulari 3: Skenari A, B, C... deri në fund
Për të kontrolluar efektivitetin e sistemit të treguesve të rimëkëmbjes dhe aftësinë për t'u rimëkëmbur (masat e rimëkëmbjes), në planin e rimëkëmbjes duhen përfshirë disa skenarë hipotetikë krizash. Duke marrë si shembull formatin e paraqitur në Formularin 3, mund të shtoni skedarë (worksheets) të tjerë për secilin nga skenarët e ndërtuar. Kur të kopjoni, lutem fillojeni emrin e çdo tabelë me "F3" (d.m.th. "F3 - Skenari A", "F3 - Skenari B",...). Për të matur ndikimin e skenarit, supozoni se nuk është përdorur asnjë masë rimëkëmbjeje. Ju lutem jepini të gjitha efektet në mënyrë kumulative.
Formulari 4: Masat e rimëkëmbjes nën skenarin A, B, C...deri në fund
Ashtu si për Formularin 3, kopjoni dhe plotësoni nga një shembull të Formularit 4 për çdo skenar. Formulari 4 është i njëjtë si strukturë me Formularin 2. Diferenca qëndron se ndërkohë që Formulari 2 teston ndikimin e përgjithshëm të masave të rimëkëmbjes në treguesit e rimëkëmbjes (d.m.th. pavarësisht nga skenari), për Formularin 4 duhet të ofrohen shifrat për ndikimin e masave në skenarin specifik (d.m.th. disa nga masat mund të mos jenë më të zbatueshme, efektet e masave mund të ndryshojnë në një skenar specifik, etj.). Formulari 4 është i plotësuar që më parë nga Formulari 2, megjithatë vlerësoni për çdo qelizë individuale e nëse vlerat janë ende të vlefshme, sipas supozimeve të skenarit dhe nëse nevojitet, shkruani mbi ato (për shembull <i>haircuts</i> më të larta mbi shitjet e aktiveve në një krizë sistematike).
Të gjithë formularët
1. Nuk duhet të shtoni rreshta dhe kolona në tabelë, nëse nuk është lejuar me një koment.
2. Qelizat në ngjyrë të verdhë i marrin vlerat nga informacioni i vendosur në tabelat e mëparshme (p.sh. F2b dhe F4 i referohen F2a-së). Në raste të devijimeve të vlerave (p.sh. një masë ka efekte më të ulëta në një skenar specifik), ju duhet të shkruani mbi formulat.
3. Qelizat në ngjyrë gri nuk duhet të ndryshohen. Nuk duhet të shkruani mbi formulat. Këto qeliza qëllimisht nuk janë të bllokuara (lock), për të krijuar sa më tepër fleksibilitet.
4. Ju lutem përzgjidhni njësinë matëse "Përqindje" dhe vendosini vlerat pa i shoqëruar me ndonjë njësi (p.sh. një tregues likuiditeti prej 120 për qind do të shkruhet në F1 si "120", jo "120%", "1,2" etj.).
Formularët F2a, F2b, F4
Formularët janë hartuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, me qëllim që t'u ofrojnë të gjitha bankave hapësirën e mjaftueshme për të përshkruar masat e tyre. Bankat mund të mos i plotësojnë të gjithë rreshtat.

**VENDIM****Nr. 73, datë 6.12.2017****PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “MBI PARIMET BAZË
TË DREJTIMIT TË BANKAVE DHE
DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA DHE
KRITERET PËR MIRATIMIN E
ADMINISTRATORËVE TË TYRE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 24, pika 1, shkronja “c” dhe “ë” dhe pika 2, shkronja “b”; të nenit 40 shkronja “c” dhe të nenit 42 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, miratuar me vendimin nr. 63, datë 14.11.2012 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, pika 2, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) shkronja “c” ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“oreksi/toleranca ndaj rrezikut” është niveli i agreguar dhe llojet e rrezikut që banka është e gatshme/në gjendje të ndërmarrë, brenda kapacitetit të rrezikut, për arritjen e objektivave strategjike të veprimtarisë dhe planit të biznesit të saj;

ii) pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me përmbajtjen e mëposhtme:

“kapaciteti i rrezikut” është niveli maksimal i rrezikut që banka mund të ndërmarrë, duke konsideruar mbështetjen tek kapitali, likuiditeti, kapaciteti huamarrës dhe kufijtë rregullatorë.”;

b) Në nenin 5, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 1, togfjalëshi “tolerancën së tij” zëvendësohet me togfjalëshin “oreksin /tolerancën ndaj tij”;

ii) shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Banka harton një politikë të veçantë për emërimin e anëtarëve të këshillit drejtues, duke specifikuar kërkesat mbi diversifikimin e përbërjes së këshillit drejtues, në funksion të sigurimit të njohurive, kualifikimeve dhe eksperiencave kolektive të tij (këshillit drejtues), në fusha të ndryshme të drejtimit dhe të kontrollit.”;

c) Në nenin 13, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 1, shtohet paragrafi “Kjo strukturë/njësi ka autoritetin, reputacionin, njohuritë dhe burimet e mjaftueshme, të cilat sigurojnë zbatimin e politikave të rrezikut dhe të kuadrin të administrimit të rreziqeve, si dhe të proceseve efektive të administrimit të rrezikut.”;

ii) pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Struktura/njësia e administrimit të rrezikut është e pavarur nga linjat e biznesit dhe nga njësitë e brendshme që kontrollojnë, si dhe ka linjë të veçantë raportimi dhe varësie prej tyre. Në çdo rast, kjo strukturë bashkëvepron me linjat e biznesit /njësitë e brendshme, me qëllim arritjen e objektivave. Ndërveprimi midis funksioneve operacionale dhe strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut duhet të ndihmojë në arritjen e objektivave të të gjithë stafit të bankës që është përgjegjës për administrimin e rreziqeve.”;

iii) pika 4 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Drejtuesi i strukturës/njesisë së administrimit të rrezikut duhet të ketë njohuri, pavarësi dhe eksperiencë të mjaftueshme për vendimet, të cilat prekin ekspozimin e bankës ndaj rreziqeve, si dhe raportin në mënyrë periodike në këshillin drejtues (duke i siguruar një informacion gjithëpërfshirës dhe të kuptueshëm këtij organi), në komitetin e rrezikut dhe tek drejtorja/drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i bankës.”;

iv) në pikën 5, pas togfjalëshit “banka gjatë aktivitetit të saj”, shtohet togfjalëshi “, si dhe të kryejnë trajnime të rregullta.”;

v) në pikën 6, pas togfjalëshit “konsideratat e përshtatshme për bankën”, shtohet togfjalëshi “, si dhe jep rekomandimet e nevojshme për përmirësimet e kuadrin të administrimit të rrezikut dhe për masat korrigjuese për ndreqjen e shkeljeve në politikat, procedurat dhe kufizimet e rrezikut.”;



vi) pas pikës 8 shtohen pikat 9 deri 19, me përmbajtjen e mëposhtme:

“9. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut përfshihet paraprakisht në hartimin e strategjisë së rrezikut dhe siguron që banka ka krijuar procese efektive të administrimit të rrezikut. Kjo strukturë /njësi i siguron këshillit drejtues të gjithë informacionin e nevojshëm për çështjet që lidhen me rrezikun, me qëllim përcaktimin e nivelit të oreksit/tolerancës ndaj rrezikut nga këshilli.

10. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson qëndrueshmërinë e strategjisë dhe oreksit/tolerancës ndaj rrezikut dhe siguron që oreksi/toleranca ndaj rrezikut të përshtatet në mënyrën e duhur me kufijtë specifikë të ekspozimeve ndaj rrezikut.

11. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson strategjitë e rrezikut të njësive të biznesit (duke konsideruar edhe objektivat e propozuar nga këto njësi) dhe ia paraqet këtë vlerësim këshillit drejtues, përpara se të marrë vendime mbi këto strategji. Objektivat e njësive të biznesit duhet të jenë të besueshëm dhe në përputhje me strategjinë e rrezikut të bankës.

12. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut përfshihet në vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve të rëndësishme (materiale) dhe të transaksioneve jo të zakonshme mbi rrezikun e përgjithshëm të bankës dhe të grupit bankar/financiar, si dhe raporton gjetjet drejtpërdrejt tek këshilli drejtues, përpara se të merren vendimet mbi këto ndryshime apo transaksione.

13. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson ndikimin e rreziqeve të identifikuara, në aftësinë e bankës apo të grupit bankar/financiar për të administruar profilin e rrezikut, si dhe likuiditetin e bazën e qëndrueshme të kapitalit të tij, në rrethana normale dhe të pafavorshme.

14. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut siguron që rreziqet identifikohen, vlerësohen, maten, monitorohen, administrohen, zbuten dhe raportohen nga dhe tek njësitë përkatëse të bankës.

15. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut siguron që të analizohen transaksionet me personat e lidhur, si dhe të identifikohen dhe vlerësohen në mënyrë të përshtatshme rreziqet që ato krijojnë për bankën.

16. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut siguron që të gjithë rreziqet e identifikuara të mund

të monitorohen në mënyrë efektive nga njësitë e biznesit.

17. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut monitoron rregullisht profilin ekzistues të rrezikut të bankës dhe e shqyrton atë në kuadër të objektivave strategjike të bankës dhe të oreksit/tolerancës ndaj rrezikut, duke informuar në mënyrë të plotë, gjithëpërfshirëse dhe të mjaftueshme këshillin drejtues.

18. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson mënyrat e mundshme për të zbutur rreziqet, si dhe i propozon këshillit drejtues planin e veprimeve të përshtatshme për zbutjen e rrezikut.

19. Bankat përcaktojnë në procedurat e tyre të brendshme, edhe rregullat për miratimin e vendimeve, mbi të cilat drejtuesi i strukturës /njësisë së administrimit të rrezikut ka shprehur opinion negativ. Këshilli drejtues komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë me drejtuesin e kësaj strukture/njësie mbi çështje me rëndësi të rrezikut, përfshirë edhe zhvillime që mund të mos jenë në përputhje me oreksin/tolerancën ndaj rrezikut dhe strategjinë e rrezikut të bankës.”;

d) Në nenin 14, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Struktura/njësia e përputhshmërisë është e pavarur nga linjat e biznesit dhe nga njësitë e brendshme që kontrollojnë dhe ka autoritetin, reputacionin dhe burimet e mjaftueshme.”;

ii) në pikën 3, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “c/1” me përmbajtjen e mëposhtme:

“vlerësimin e ndikimit të mundshëm të çdo ndryshimi ligjor dhe rregullativ në veprimtarinë e bankës dhe në kuadrin e përputhshmërisë”;

e) Në nenin 15, pika 5, togfjalëshi “tolerancës së rrezikut” zëvendësohet me togfjalëshin “oreksit/tolerancës ndaj rrezikut”;

f) Në nenin 16, pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Administratori i bankës gëzon reputacion të lartë etik, nëse:

a) nuk është në ndjekje penale, në gjykim për vepra penale dhe i dënuar penalisht;

b) ka vepruar me kompetencë në ushtrimin e funksioneve dhe në përshtatje me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankës (nëse është e aplikueshme);



c) ka treguar korrektësi në drejtim dhe, në veçanti, transparencë dhe bashkëpunim në marrëdhëniet me autoritetin mbikëqyrës dhe në qëndrimin ndaj masave mbikëqyrëse dhe ndëshkimore të tij (autoritetit mbikëqyrës);

d) ka arritur rezultate të larta dhe ka shfaqur integritet profesional gjatë ushtrimit të funksioneve apo eksperiencave të mëparshme;

e) nuk ka të dhëna mbi gjendjen financiare, të cilat mund të cenojnë reputacionin e tij ose të dhëna të tjera, të cilat krijojnë dyshime të arsyeshme mbi reputacionin e këtij individi; si dhe

f) ndaj tij nuk janë marrë masa disiplinore të largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit/vlerësimit, përveç rasteve kur masa disiplinore është konsideruar në kundërshtim me ligjin, me vendim gjykatë të formës së prerë.”;

g) Në nenin 17, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 1, pas togfjalëshit “me pikën 2 ose 3 të këtij neni” shtohet togfjalëshi “brenda 30 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit të organit vendimmarrës.”;

ii) në pikën 2, pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l” me përmbajtjen e mëposhtme:

“vërtetimi ose raporti i kredimarrësit nga regjistri i kredive ose një dokument ekuivalent i lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj.”;

h) Në nenin 18 kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 1, pas shkronjës “a”, shtohen shkronja “a/1” dhe “a/2” me përmbajtjen e mëposhtme:

“a/1) një analize të përgatitur nga banka që propozon administratorin, mbi përshtatshmërinë e njohurive profesionale të tij (administratorit), lidhur me pozicionin për të cilin propozohet, e cila bazohet kryesisht në:

i) kohëzgjatjen, natyrën dhe kompleksitetin e eksperiencave të mëparshme të administratorit të propozuar;

ii) kompetencat, vendimmarrjet dhe përgjegjësitë e ushtruara në pozicionet e mëparshme të punës;

iii) njohuritë e përfituara nga këto pozicione pune, mbi institucionet financiare dhe rreziqet që përballen këto institucione;

iv) numrin e punonjësve që ka pasur në varësi;

v) argumentet dhe arsyet e përshtatshmërisë së administratorit të propozuar, me veprimtarinë, funksionet dhe detyrat që do të kryejë; si dhe

vi) vlerësimin e bankës mbi rezultatet e arritura dhe integritetin profesional të shfaqur, gjatë ushtrimit të funksioneve apo eksperiencave të mëparshme;

a/2) një vlerësimi të përgatitur nga banka, mbi kohën e nevojshme në dispozicion, që administratori i propozuar do t'i dedikojë përmbushjes së funksionit dhe përgjegjësisë të tij, i cili (vlerësimi) duhet të bazohet kryesisht në angazhimin e tij si rrjedhojë e numrit të pozicioneve që ai mund të mbajë edhe në struktura të tjera drejtuese të filialeve të të njëjtit grup bankar apo në subjekte ku banka zotëron pjesëmarrje të rëndësishme.”

ii) pas pikës 4, shtohet pika 5 dhe 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

“5. Në rast se administratori mban disa pozicione në struktura të tjera drejtuese të filialeve të të njëjtit grup bankar apo në subjekte ku banka zotëron pjesëmarrje influencuese, Banka e Shqipërisë i kërkon bankës që administratori të lirohet nga një ose disa funksione, të cilat pengojnë punën e administratorit me kohë të plotë.

6. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratimin e administratorit, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për miratim, nuk plotësohen nga banka brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për marrjen e miratimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratim, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim bankën.”;

i) Në nenin 19, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Emërtimi i nenit 19 “Miratimi në rast ndryshimi të pozicionit të administratorëve”, ndryshon në “Miratimi në rastet e ndryshimit të pozicionit të administratorëve ose riemërimit të tyre”;

ii) Në pikën 1, fjala “riemërim” do të zëvendësohet me “emërim” dhe fjala “riemërimi” do të zëvendësohet me “emërim”;

iii) Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“1/1. Banka, në rastet e riemërimit të administratorit në të njëjtin pozicion, paraqet në Bankën e Shqipërisë një kërkesë me shkrim për



miratimin e këtij riemërimi. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e riemërimit, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 17 të kësaj rregulloreje;

b) CV-në e përditësuar, të plotësuar sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

c) një informacion/relacion të detajuar për vlerësimin dhe kontributin e administratorit, në drejtimin efektiv të bankës (për shembull një vlerësim të performancës së drejtuesit ekzekutiv, të kontributit të anëtarit të këshillit drejtues në mbledhjet e këtij organi etj.);

d) informacione të tjera shtesë, të cilat mund të gjykojnë të nevojshme.”;

iv) pika 2, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Banka e Shqipërisë mund të refuzojë dhënien e miratimit paraprak për emërimin e administratorit në një pozicion të ndryshëm nga ai ekzistues dhe/ose për riemërimin e tij, kur mbi bazën e vlerësimeve të saj, çmon se kualifikimet dhe përvoja e tij nuk janë të përshtatshme me pozicionin e propozuar si administrator apo kontributi i tij nuk vlerësohet i konsiderueshëm.”;

j) Pas nenit 19, shtohet neni 19/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 19/1

Procesi i rivlerësimit të administratorëve

1. Bankat kryejnë rivlerësimin e përshtatshmërisë së administratorëve të miratuar gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të paktën një herë në vit, si dhe në rastet kur gjykojnë të nevojshme, bazuar në rrethana apo fakte të veçanta.

2. Bankat, nëpërmjet procesit të rivlerësimit të përshtatshmërisë së administratorëve të miratuar, sigurojnë plotësueshmërinë në vazhdimësi të kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Bankat dokumentojnë procesin e rivlerësimit të përshtatshmërisë për të gjitha kategoritë e administratorëve, respektivisht, të anëtarëve të këshillit drejtues, anëtarëve të komitetit të kontrollit dhe të drejtuesve ekzekutivë.

4. Bankat parashikojnë detyrimin për të gjithë administratorët, të cilët duhet të njoftojnë bankën për çdo rrethanë apo fakt që ka ndikim të rëndësishëm në përshtatshmërinë e tyre, për të realizuar funksionet, për të cilët ata janë miratuar ose të konfirmojnë, të paktën një herë në vit, që

nuk kanë ndryshuar të dhënat mbi të cilat është dhënë miratimi paraprak nga Banka e Shqipërisë.”;

k) Në nenin 22, shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratimin për të përfunduar me të tretët marrëveshje për transferimin e funksioneve dhe përgjegjësi për drejtimin e saj, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për miratim nuk plotësohen nga banka brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për marrjen e miratimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratim, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim bankën.”;

l) Në nenin 23, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 1, pas togfjalëshit “kompleksitetin e veprimtarisë së tyre”, shtohet togfjalëshi “, si dhe në veçanti strukturën organizative që siguron një ndarje të qartë të detyrave, përgjegjësi dhe raportimit, sipas modelit të tre linjave të kontrollit.”;

ii) Pas pikës 1, shtohen pikat 2 dhe 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Bankat, si pjesë të raportit vjetor të tyre, publikojnë një deklaratë të veçantë për oreksin/tolerancën ndaj rrezikut të ndërmarrë, në përmbushje të objektivave të tyre strategjikë. Deklarata rishikohet nga këshilli drejtues mbi baza vjetore dhe në çdo rast që evidentohen ndryshime të rëndësishme (materiale) në veprimtarinë e tyre, të cilat mund të ndryshojnë qasjen/vendimmarrjen e këshillit drejtues për oreksin/tolerancën ndaj rrezikut.

Bankat sigurojnë që deklarata e oreksit /tolerancës ndaj rrezikut, të adresojë çështjet e kulturës dhe oreksit/tolerancës ndaj rrezikut dhe kapaciteteve të rrezikut të bankës, gjatë ushtrimit të veprimtarive bankare e financiare.”;

m) Në tabelën e aneksit 1, pas pikës 6 “Eksperienca në punë”, shtohen dy rreshta me përmbajtjen e mëposhtme:

PJESËMARRJE NË KËSHILLA DREJTUESE/NË SHOQATA PROFESIONISTËSH

1. (lutemi listoni shoqëritë/shoqatat ku jeni ose keni qenë anëtar i këshillave drejtues, datat e pjesëmarrjes etj.)

Emri dhe adresa e punëdhënësit

n) Pas aneksit 3, shtohet aneksi 4 me përmbajtjen e mëposhtme:



ANEKSI 4

PËRBËRJA E KËSHILLIT DREJTUES TË BANKËS DHE INTERESAT PRIVATË TË ANËTARËVE TË TIJ, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË NENIT 44, PIKA 2^t TË LIGJIT NR. 9662, DATË 18.12.2006, “PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR[†]
(Ky formular plotësohet nga banka në momentin e aplikimit të një ose disa anëtarëve të këshillit drejtues, për të vlerësuar strukturën aktuale të këshillit drejtues të bankës)

Nr.	Emri i anëtarit të këshillit drejtues	Pozicioni aktual i punësimit të anëtarit të këshillit drejtues dhe emri i punëdhënësit	Marrëdhëniet e interesave private të anëtarit të këshillit drejtues me:			Afati i emërimit në këshillin drejtues të bankës (datë, muaj, vit-datë, muaj, vit)
			Bankën	Aksionarët që ushtrojnë kontroll mbi bankën	Drejtuesit ekzekutivë	
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në 30 prill 2018.

KRYETARI
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 74, datë 6.12.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR SISTEMIN
E KONTROLLIT TË BRENDSHËM”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 47, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për sistemin e kontrollit të brendshëm”, miratuar me vendimin nr. 67, datë 2.9.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

* Interesat privatë të anëtarit të këshillit drejtues me bankën dhe/ose me aksionarin/ët që ushtron/jnë kontroll mbi bankën dhe/ose me drejtuesit ekzekutivë të bankës, të përcaktuara sipas nenit 44, pika 2 të ligjit për bankat janë:

- marrëdhënie pasurore ose tregtare të drejtpërdrejta ose të tërthorta të çdo lloji natyre,
- çdo marrëdhënie tjetër juridiko – civile,
- dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale,
- negociime të mundshme për punësim apo për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për administratorin në të ardhmen, pas lënies së detyrës si administrator, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës si administrator në bankë,
- angazhime në veprimtari të tjera private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura,
- marrëdhënie familjare ose të bashkëjetesës.

* Lutemi plotësoni përgjigjet në kutiza me “po” ose “jo”. Në rast të plotësimit me “po” të jepen shpjegime për llojin e marrëdhënies së interesave privatë të anëtarit të këshillit drejtues sipas (*) më lart.”.



a) Në nenin 7, pika 2, togfjalëshi “ekspertëve kontabël të autorizuar” zëvendësohet me togfjalëshin “audituesit ligjor ose shoqërisë së auditimit”;

b) Në nenin 8, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 1, përmbajtja e shkronjës “b” ndryshon si më poshtë:

“siguron që njësia e kontrollit të brendshëm t’i kryejë detyrat e saj në mënyrë të pavarur dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm;”

ii) Në pikën 1, shkronja “c”, togfjalëshi “ekspertët kontabël të autorizuar” zëvendësohet me togfjalëshin “audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit, komitetin e kontrollit”;

iii) Shkronja “e” e pikës 1, bëhet pika “2” e këtij neni, me përmbajtjen e mëposhtme:

“Komiteti i kontrollit mund t’i propozojë këshillit drejtues, emërimin ose shkarkimin e drejtuesit dhe punonjësve të njësisë së kontrollit të brendshëm.”;

iv) Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Anëtarët e komitetit të kontrollit mund të jenë anëtarë të këshillit drejtues, si dhe kryetari i komitetit të kontrollit duhet të jetë në çdo rast anëtar i këshillit drejtues të bankës.”;

c) Në nenin 12 shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Njësia e kontrollit të brendshëm zbaton standardet ndërkombëtare të kontrollit të

brendshëm, sipas përcaktimeve të ligjit “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar.”;

d) Në nenin 14, pika 1, shkronja “a”, pas togfjalëshit “në zbatimin e standardeve” shtohet togfjalëshi “ndërkombëtare”;

e) Në nenin 15, pika 3, shkronja “e”, kryhet ndryshimi i mëposhtëm:

i) Togfjalëshi “ekspertët kontabël të autorizuar” zëvendësohet me togfjalëshin “audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit”;

ii) Pas nenit 22, shtohet neni 23 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 23

Dispozitë kalimtare

Bankat ndërmarrin masat e nevojshme për plotësimin e kërkesës së nenit 8, pika 3, të kësaj rregulloreje, brenda vitit 2018.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja KRISTALINA
Tiranë, 2017

Çmimi 392 lekë